FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 80

Tiranë – E martë, 5 maj 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 40/2020 datë 23.4.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9870, datë 4.2.2008, "Për standardizimin", të ndryshuar.....	4425
Dekret i Presidentit nr.11470, datë 30.4.2020	Për shpallje ligji.....	4425
Ligj nr. 41/2020 datë 23.4.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9587, datë 20.7.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit", të ndryshuar.....	4426
Dekret i Presidentit nr. 11471, datë 30.4.2020	Për shpallje ligji.....	4434
Dekret i Presidentit nr. 11467, datë 29.4.2020	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	4434
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 29.4.2020	Për miratimin e rregullit teknik "Për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionit" dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara.....	4435
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 81, datë 6.3.2020	Për klasifikimin e objekteve, sipas rrezikshmërisë nga zjarri, procedurat e shqyrtimit dhe të miratimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe dhënia e certifikatës së sigurisë nga zjarri.....	4516
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 266, datë 21.4.2020	Për përcaktimin e kategorive të bizneseve, sipas niveleve të riskut dhe miratimin e protokolleve të masave higjieno-sanitare dhe të distancimit social për parandalimin e përhapjes së COVID-19.....	4534
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3420/2, datë 29.4.2020	Për shpronësim për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza Lindore Tiranë (lotet I, II)".....	4554

LIGJ
Nr. 40/2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9870, DATË 4.2.2008, "PËR STANDARDIZIMIN", TË NDRYSHUAR[1]

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9870, datë 4.2.2008, "Për standardizimin", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 8 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 5 bëhen këto ndryshime:

a) Fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

"5. DPS-ja është Autoriteti Kombëtar i Notifikimit dhe Pika Kombëtare e Referimit në OBT dhe në CEFTA për projektstandardet, projektrregullat teknike dhe projektprocedurat e vlerësimit të konformitetit me ndikim në tregti.".

b) Në paragrafin e dytë, fjalët "pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për çdo notifikim të saj pranë OBT-së." zëvendësohen me fjalët "pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë, për çdo notifikim të saj pranë OBT-së dhe CEFTA-s.".

2. Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

"7. Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit është Administratori Kombëtar i Regjistrimit për Lëshuesit (NRA/I).".

Neni 2

Në nenin14 bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën "ë", pas fjalës "informacioni" shtohen fjalët "për tregun e brendshëm dhe atë unik europian".

2. Në fund të shkronjës "f" shtohen fjalët "dhe Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me Europën Qendrore (CEFTA).".

3. Pas shkronjës "f" shtohet shkronja "f/1" me këtë përmbajtje:

"f/1) zbaton detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i direktivave dhe i rregulloreve të Bashkimit Europian për standardizimin dhe fushat që lidhen me të, si dhe është pikë kontakti për dhënien e informacionit për disa nga produktet që vendosen në treg.".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletore Zyrtare.

Miratuar në datën 23.4.2020

Shpallur me dekretin nr. 11470, datë 30.4.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET
Nr. 11470, datë 30.4.2020

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 40/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9870, datë 4.2.2008 "Për standardizimin", të ndryshuar".

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

[1] *Ky projektligj është në përputhje dhe për zbatimin e kërkesave të standardit shqiptar, i cili specifikon strukturën e të dhënave për sistemet e telematikës në transportin e qarkullimin rrugor - Identifikimi automatik i automjeteve dhe pajisjeve - Kodifikimi dhe struktura e të dhënave, SSH EN ISO 14816:2005 (ose me çdo amendim apo ripublikim të tij në të ardhmen).*

LIGJ
Nr. 41/2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN Nr.9587, DATË 20.7.2006, "PËR MBROJTJEN E BIODIVERSITETIT", TË NDRYSHUAR[2]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit", të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 2 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Pika 12 shfuqizohet.

2. Pika 17 ndryshohet si më poshtë:

"17. "Material gjenetik" është çdo material me origjinë bimore, shtazore, mikrobiale ose tjetër, që përmban njësi funksionale të trashëgueshmërisë.".

3. Pika 38 ndryshohet si më poshtë:

"38. "Rrjeti i zonave të mbrojtura" është sipas kuptimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për zonat e mbrojtura.".

4. Pika 43 ndryshohet si më poshtë:

"43. "Njësitë e vetëqeverisjes vendore" kanë të njëjtin kuptim të dhënë në legjislacionin për vetëqeverisjen vendore.".

5. Pikat 44, 45, 46 dhe 47 shfuqizohen.

6. Pas pikës 47, shtohen pikat 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57 e 58 me këtë përmbajtje:

"48. "Akses" nënkupton lejimin, përvetësimin dhe ndarjen e burimeve gjenetike ose të njohurive tradicionale të lidhura me to.

49. "Burime gjenetike të përdorura në mënyrë të paligjshme" janë burimet gjenetike dhe njohuritë tradicionale të lidhura me burimin gjenetik, por të përdorura pa u respektuar detyrimet ligjore të përcaktuara në këtë ligj, ose detyrimet e parashikura në Protokollin e Nagoyas, i ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 113/2012, datë 22.11.2012.

50. "Certifikatë e pajtueshmërisë së njohur ndërkombëtarisht" (këtu e në vijim Certifikata) ka kuptimin e një akti të lëshuar nga ministria, që vërteton se burimi gjenetik që do të përdoret apo të dhënat që ai prodhon janë në përputhje me kushtet e miratuara nga lëshuesi i kësaj certifikate.

51. "Deklarata e kontrollit të detajuar të kërkimit shkencor" është deklarata e kërkuesit, në të cilën shprehet se kërkimi shkencor do të zbatojë parimin e kujdesit të duhur në këtë proces.

52. "Kushte të pranuara reciprokisht" ka kuptimin e marrëveshjeve kontraktuale, të lidhura ndërmjet furnizuesit të burimit gjenetik ose të njohurive tradicionale të lidhura me burimin gjenetik dhe një përdoruesi të mirëpërcaktuar, me anë të të cilave përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve, përfshirë edhe ndarjen e drejtë dhe të barabartë të fitimit që do të vijë si pasojë e shfrytëzimit të burimit gjenetik apo të njohurive tradicionale të lidhura me burimin gjenetik.

53. "Njohuri tradicionale e lidhur me burimin gjenetik" është njohuri e posaçme, e zotëruar nga një vendas apo një komunitet vendas afër burimit gjenetik, e cila ka vlerë të rëndësishme në lidhje me përdorimin e këtij burimi gjenetik dhe që është e përshkruar si e tillë në kushtet e pranuara reciprokisht të zbatueshme lidhur me përdorimin e burimit gjenetik.

54. "Përdorues" është një person fizik apo juridik, që përdor burime gjenetike ose njohuri tradicionale të lidhura me burimet gjenetike.

55. "Protokolli i Nagoyas" është protokolli për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë e të barabartë të përftimeve që rrjedhin nga përdorimi i tyre.

56. "Pëlqimi paraprak i informuar" nënkupton miratimin administrativ të dhënë nga autoriteti kombëtar kompetent i një vendi ofrues të burimeve gjenetike një përdoruesi të tyre, para aksesit në

[1] *Ky ligj është përafruar pjesërisht me Rregulloren (BE) nr. 511/2014, datë 16 prill 2014, të Parlamentit Europian dhe të Këshillit "Mbi masat e pajtueshmërisë për përdoruesit nga Protokolli i Nagoyas mbi aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që realizohen nga përdorimi i tyre në Union". Numri CELEX 32014R0511, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 150, datë 20.5.2014, faqe 59 - 71*

burimet gjenetike, në përputhje me përcaktimin e Protokollit të Nagoyas.

57. "Shfrytëzim i burimeve gjenetike" është kryerja e kërkimeve, me qëllim zhvillimin gjenetik dhe/ose biokimik të burimit gjenetik, përfshirë përdorimin e bioteknologjisë, sipas kuptimit të nenit 2 të Protokollit të Nagoyas.

58. "Vjelja" është procesi i grumbullimit, ruajtjes së grupmostrave të mbledhura ose informacionit përkatës dhe i mbajtjes së tyre nga subjektet fizike e juridike, publike ose private.".

Neni 2

Në nenin 3, pika 1, pas shkronjës "c" shtohet shkronja "ç" me këtë përmbajtje:

"ç) për të gjitha burimet gjenetike dhe njohuritë tradicionale të këtyre burimeve gjenetike.".

Neni 3

Titulli i kreut IV/I ndryshohet si më poshtë:

"Lista e llojeve të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve e shpendëve dhe raportimi".

Neni 4

Nenet 17/1, 17/2, 17/3, 24, pika 2, dhe 44 shfuqizohen.

Neni 5

Në nenin 17/5, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Ministria përgatit, çdo 6 vjet, raportin për zbatimin e masave të marra, sipas dispozitave të këtij ligji, të ligjit për zonat e mbrojtura dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tyre.".

Neni 6

Neni 32 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 32
Importimi dhe/ose introduktimi

1. Importimi dhe/ose introduktimi i qëllimshëm i llojeve të huaja ose i llojeve të huaja invazive në mjediset tokësore, ujore ose detare të Republikës së Shqipërisë bëhet vetëm pas vlerësimit të ndikimit në mjedis, referuar legjislacionit në fuqi, duke provuar se një lloj i huaj apo invaziv nuk do të ndikojë negativisht në mjedis, në shëndetin e njeriut dhe në zhvillimin e qëndrueshëm.

2. Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet, të paktën:

a) të bëhet për çdo rast konkret, përpara futjes së tij në vendin tonë;

b) të bëhet me metoda shkencore;

c) të bazohet në teknika të njohura vlerësimi;

ç) të mbështetet në udhëzime të njohura ndërkombëtare.

3. Aplikimi për vlerësimin e ndikimit në mjedis, përveç procedurave dhe dokumentacionit referuar legjislacionit në fuqi, përfshin edhe:

a) masat për menaxhimin dhe kontrollin e rreziqeve të identifikuara;

b) një program monitorimi;

c) një plan për menaxhimin e pasojave të padëshirueshme apo situatave emergjente;

ç) një garanci financiare për të përballuar pasojat e padëshirueshme apo situatat emergjente.

4. Llojet e huaja ose llojet e huaja invazive, përpara introduktimit të lejuar të tyre ose të produkteve që ato përmbajnë, u nënshtrohen eksperimenteve të nevojshme.

5. Për të gjithë organizmat, për të cilët lejohet importimi ose introduktimi, bëhet regjistrimi në regjistër të hapur për publikun. Formatin, kriteret e regjistrimit e të çregjistrimit dhe rregullat e administrimit të këtij regjistri miratohen me urdhër të ministrit.

6. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton listën e llojeve të huaja ose llojeve të huaja invazive dhe përcakton procedurat për ndalimin dhe/ose futjen e tyre në pikat doganore të vendit.".

Neni 7

Neni 37 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 37
Ruajtja

Përdoruesit e llojeve dhe të burimeve gjenetike të metodave të ruajtjes *ex-situ* krijojnë kushtet e nevojshme për mirëmbajtjen dhe plotësojnë metodat e ruajtjes *in-situ*.".

Neni 8

Neni 41 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 41
Lejimi i veprimtarisë së shfrytëzimit dhe përdorimit të diversitetit biologjik

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, veprimtaritë që shfrytëzojnë e përdorin elemente të diversitetit biologjik dhe të përbërësve të tij do të trajtohen sipas legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis në rastet kur:

a) veprimtaria kërkimore është në përputhje me kërkesat e këtij ligji;

b) janë siguruar informacione për personat juridikë dhe fizikë, që do të kryejnë kërkime, për përdorimin e mëvonshëm të materialeve kërkimore, objekt studimi, si dhe informacione të tjera shoqëruese;

c) parashikohet se veprimtaria kërkimore do të ketë ndikim negativ në diversitetin biologjik.

2. Përparësi u jepet veprimtarive kërkimore që ndikojnë në masat e ruajtjes e të përdorimit të qëndrueshëm, si dhe në rrjetin e inventarizimit e monitorimit të biodiversitetit.

3. Përdorimet e mëvonshme të materialit gjenetik dhe të molekulave biologjike, të lidhura me materialin e mbledhur, realizohen vetëm me pëlqimin e ministrisë dhe/ose të pronarit dhe u nënshtrohen kushteve për ndarjen e përfitimeve.

4. Kur veprimtaritë kërkimore janë propozuar nga persona juridikë dhe fizikë të huaj, miratimi përkatës, përveç të tjerave, përmban edhe këto kushte:

a) ndarjen ose përdorimin e mëvonshëm të materialeve kërkimore ndërmjet studiuesve, vendas e të huaj, duke u mbështetur në kushtet e vendosura paraprakisht në kontratë dhe në bazë të rezultateve përfundimtare;

b) të drejtën që Republika e Shqipërisë t'i shfrytëzojë a përdorë kampionet ose produktin e arritur dhe të dhënat e mbledhura nëpërmjet këtyre veprimtarive;

c) vlerësimin e të dhënave, për zyrtarizimin e tyre;

ç) pëlqimin e dhënë nga ministria dhe/ose institucioni përgjegjës respektiv, që të dhënat e rezultateve të kërkimeve të pasqyrohen në rrjetet ndërkombëtare të informacionit;

d) mbledhja nga burime *in-situ* dhe përdorimi i sasive të konsiderueshme të bimëve, kafshëve apo materialit mikrobik, të materialit gjenetik apo të molekulave të tjera biologjike, si dhe të dhënave shoqëruese, është e ndaluar pa miratimin përkatës, referuar legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis.".

Neni 9

Titulli i kreut X ndryshohet si më poshtë:

"Mbledhja dhe përdorimi i burimeve gjenetike shqiptare *in-situ* dhe *ex-situ* dhe i njohurive tradicionale të lidhura me to".

Neni 10

Nenet 42 dhe 43 ndryshohen si më poshtë:

"Neni 42
Mbledhja dhe përdorimi i materialeve biologjike e i kampioneve të mjedisit nga burime *in-situ*

Veprimtaria e mbledhjes nga burime *in-situ* dhe përdorimi i sasive të konsiderueshme të bimëve, kafshëve apo materialit mikrobik, të materialit gjenetik apo të molekulave të tjera biologjike, si dhe të dhënave shoqëruese i nënshtrohet procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis, referuar legjislacionit në fuqi, kur:

a) është siguruar informacioni i plotë për personat juridikë dhe fizikë, që kërkojnë materialet për veprimtaritë e propozuara dhe për përdorimin e mëvonshëm të materialeve që duhen mbledhur;

b) veprimtaria mbledhëse nuk është e ndaluar me ligj;

c) pronarët e materialit, të cilëve u është dhënë informacion i plotë për veprimtarinë e propozuar dhe për përdorimet e mëvonshme, kanë dhënë pëlqimin paraprak, të informuar, që lidhet me aksesin dhe përdorimin e çdo të dhëne shoqëruese;

ç) është rënë dakord për kushtet e përdorimit të mëvonshëm të materialeve dhe për ndarjen e përfitimeve, monetare dhe jomonetare, me Republikën e Shqipërisë ose me pronarët private.

Neni 43
Përdorimi i kampioneve të materialeve biologjike nga burime *ex-situ*

Përdorimi i kampioneve të bimëve, kafshëve, materialit mikrobik, gjenetik apo i molekulave të tjera biologjike që ato përmbajnë, të marra nga burime *ex-situ* në pronësi apo financim publik, si dhe i të dhënave shoqëruese, bëhen me marrëveshje për transferimin e materialit të siguruar nga këto burime kur:

a) veprimtaria është e lejuar nga ligji;

b) janë siguruar të dhëna të plota për personat juridikë dhe fizikë, që i kërkojnë materialet dhe për përdorimin e mëvonshëm të tyre;

c) është rënë dakord për kushtet e përdorimit të mëvonshëm të materialeve dhe për ndarjen e përfitimeve, monetare dhe jomonetare, me Republikën e Shqipërisë ose me pronarin privat;

ç) është dhënë çdo e dhënë tjetër që kërkohet nga ministria.".

Neni 11

Pas kreut X shtohen krerët X/I, X/II dhe X/III me këtë përmbajtje:

"KREU X/I
DETYRIMET E AUTORITETIT KOMBËTAR PËRGJEGJËS

Neni 44/1
Autoriteti Kombëtar Përgjegjës dhe Pika Kombëtare e Kontaktit

1. Ministria përgjegjëse për mjedisin është Autoriteti Kombëtar Përgjegjës dhe Pikë Kombëtare e Kontaktit në Protokollin e Nagoyas.

2. Detyrimet e Autoritetit Kombëtar Përgjegjës janë:

a) vënia në dispozicion e informacionit mbi burimet gjenetike dhe përdoruesit tradicionalë të tyre;

b) dhënia e këshillimit mbi përdorimin e burimeve gjenetike dhe përdoruesve tradicionalë të tyre;

c) dhënia e aksesit për përdorimin e burimit gjenetik ose të dhënave referuar legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis të përdoruesit të burimit gjenetik;

ç) shkëmbimi i informacionit për aksesin dhe ndarjen e përfitimit;

d) monitorimi i përdoruesve të burimit gjenetik dhe informacionit përkatës;

dh) krijimi dhe përditësimi i regjistrit të koleksioneve të burimeve gjenetike;

e) raportimi pranë sekretariatit të Konventës mbi zbatimin e Protokollit të Nagoyas.

Neni 44/2
Vënia në dispozicion e informacionit

Ministria përgjegjëse për mjedisin vë në dispozicion të të interesuarve informacionet lidhur me:

a) autoritetet kombëtare përgjegjëse dhe funksionet e tyre;

b) komunitetet përkatëse të zonës ku ndodhet burimi gjenetik dhe grupet përkatëse të interesit;

c) procedurat e nevojshme për marrjen e pëlqimit paraprak, të informuar, të komunitetit të zonës ku ndodhet burimi gjenetik dhe kushtet e dakordësuara nga palët, përkatësisht, komunitetit të zonës dhe përdoruesit të burimit gjenetik, duke përfshirë këtu edhe ndarjen e përfitimeve, për subjektet kërkuese, të cilët duan të kenë akses në burimet gjenetike;

ç) procedurat për marrjen e pëlqimit paraprak, të informuar, nga komunitetet e zonës dhe vendosjen e kushteve të dakordësuara nga palët, duke përfshirë këtu edhe ndarjen e përfitimeve, për subjektet kërkuese, të cilët duan të kenë akses në njohuritë tradicionale lidhur me burimet gjenetike.

Neni 44/3
Këshillimi dhe aksesi mbi përdorimin e burimeve gjenetike dhe përdoruesve tradicionalë të tyre

Autoritetet kombëtare shkencore janë përgjegjëse për mbajtjen dhe përditësimin e informacionit mbi burimet gjenetike, të dhënave e përdoruesve tradicionalë të tij, si dhe për dhënien e këshillimit mbi burimet gjenetike.

Neni 44/4
Mekanizmi i Shkëmbimit të Informacionit për Aksesin dhe Ndarjen e Përfitimeve

1. Mekanizmi i Shkëmbimit të Informacionit për Aksesin dhe Ndarjen e Përfitimeve është një sistem elektronik, ndërkombëtar, i shpërndarjes dhe aksesit të informacionit mbi burimet gjenetike, njohuritë tradicionale dhe përdoruesit tradicionalë të tyre. Ministria përgjegjëse për mjedisin, në cilësinë e Autoritetit Kombëtar Përgjegjës, ka përgjegjësinë për administrimin, ngarkimin dhe përditësimin me të dhëna të siguruara nga autoritetet kombëtare shkencore.

2. Ministria përgjegjëse për mjedisin publikon dhe përditëson informacionin mbi certifikatat e dhëna për aksesin në burimin gjenetik apo në aksesin për informacionet përkatëse gjenetike pranë Mekanizmit të Shkëmbimit të Informacionit për Aksesin dhe Ndarjen e Përfitimit, sipas përcaktimeve në Protokollin e Nagoyas. Ky informacion vërteton edhe dhënien e pëlqimit paraprak, të informuar, dhe vendosjen e kushteve të dakordësuara nga palët.

3. Informacioni i përditësuar në sistemin elektronik, sipas pikës 2, të këtij neni, përmban:

a) autoritetin përgjegjës për lëshimin e certifikatës;

b) datën e lëshimit të certifikatës dhe afatin e vlefshmërisë së saj;

c) ofruesin;

ç) personin apo subjektin, të cilit i është dhënë pëlqimi paraprak, i informuar, nga komuniteti;

d) burimin gjenetik ose informacionin e burimit gjenetik që mbulon kjo certifikatë;

dh) periodicitetin e vetëdeklarimit të të dhënave të përdorimit të objektit të certifikatës nga mbajtësi i saj;

e) kushtet e përdorimit, referuar karakteristikave specifike të objektit të certifikatës;

ë) vërtetimin se janë vendosur kushtet e dakordësuara nga palët;

f) vërtetimin se është marrë pëlqimi paraprak, i informuar, nga komuniteti;

g) përdorimin ose jo për qëllime tregtare.

4. Certifikata lëshohet nga ministrit përgjegjës për mjedisin ose personi i autorizuar prej tij. Formati i certifikatës për akses miratohet me urdhër të ministrit.

Neni 44/5
Monitorimi i përdoruesve të burimit gjenetik dhe informacionit përkatës

1. Autoriteti përgjegjës, pas dhënies së certifikatës për akses në burimin gjenetik ose në informacionin rreth tij, ka detyrimin për monitorimin e përdorimit të objektit të certifikatës, sipas kushteve përkatëse të përcaktuara në të.

2. Ministria ose autoriteti i ngarkuar prej saj monitoron dhe kontrollon zbatimin e kushteve të certifikatës.

3. Procedura e zhvillimit të kontrolleve miratohet me urdhër të ministrit.

4. Në fazën e zhvillimit përfundimtar të objektit të certifikatës, poseduesi i saj, nëpërmjet vetëdeklarimit, njofton ministrinë se:

a) i ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga certifikata;

b) janë plotësuar kushtet e dakordësuara.

5. Ministria përditëson të dhënat e përfituara, sipas pikës 3, të këtij neni, në sistemin elektronik të Mekanizmit të Shkëmbimit të Informacionit për Aksesin dhe Ndarjen e Përfitimit, në pjesën ku është publikuar certifikata përkatëse.

Neni 44/6
Krijimi dhe përditësimi i Regjistrit të Koleksioneve të Burimeve Gjenetike

1. Ministria krijon regjistrin elektronik për koleksionin e burimeve gjenetike dhe e përditëson atë me tërësinë e burimeve gjenetike që ndodhen brenda territorit administrativ të Republikës së Shqipërisë.

2. Ky koleksion popullohet me të dhëna menjëherë pas evidentimit të një burimi gjenetik të panjohur më parë.

3. Ministria merr masa që regjistri i koleksioneve të burimeve gjenetike të jetë lehtësisht i aksesueshëm për publikun. Ministria përgjegjëse për mjedisin mban dhe përditëson në regjistrin e koleksioneve të burimeve gjenetike informacionin referuar dispozitave të këtij ligji, duke ruajtur të dhënat konfidencale dhe duke respektuar të drejtën e autorit.

KREU X/II
PROCEDURA E APLIKIMIT DHE TRAJTIMIT TË KËRKESËS PËR AKSES

Neni 44/7
Aplikimi për akses dhe procedura e vlerësimit në burimet gjenetike *in-situ*

1. Ushtrimi i aktivitetit të mbledhjes së produkteve nga burime *in-situ* dhe përdorimi i sasive të konsiderueshme të bimëve, kafshëve apo materialit mikrobik, të materialit gjenetik apo të molekulave të tjera biologjike, si dhe të dhënave shoqëruese të tyre kryhet vetëm pas pajisjes me certifikatën e aksesit.

2. Me qëllim përdorimin e materialit gjenetik dhe të molekulave biologjike, personi fizik/juridik i interesuar duhet të pajiset me certifikatë nga ministria, pas miratimit paraprak, të informuar, nga pronari i burimit gjenetik, mbi bazën edhe të kushteve të dakordësuara nga palët për ndarjen e përfitimeve.

3. Aplikimi për akses dhe informacion në burimet gjenetike apo në informacionin e tyre realizohet nëpërmjet kërkesës me shkrim pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin, sipas formatit përkatës të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për mjedisin.

4. Pas marrjes së kërkesës, sipas pikës 3, të këtij neni, ku kërkohet aksesi në burimet gjenetike *in-situ,* ministria përgjegjëse për mjedisin vlerëson nëse:

a) aplikimi përmban informacionin për personat juridikë dhe fizikë, që kërkojnë materialet për veprimtaritë e propozuara dhe për përdorimin e mëvonshëm të materialeve që vilen;

b) veprimtaria vjelëse nuk është e ndaluar me ligj;

c) aplikimi përmban informacionin për pronarët e materialit, të cilët vërtetojnë se janë informuar plotësisht për veprimtarinë e propozuar dhe për përdorimet e mëvonshme, dhe kanë dhënë pëlqimin paraprak, të informuar, të tyre për aksesin dhe përdorimin e çdo të dhëne shoqëruese;

ç) është rënë dakord për kushtet e përdorimit të mëvonshëm të materialeve dhe për ndarjen e përfitimeve, monetare dhe jomonetare, me Republikën e Shqipërisë ose me pronarët privatë të burimit gjenetik apo informacionit rreth tij.

Neni 44/8
Procedura e vlerësimit të kërkesës për akses

1. Pas marrjes së kërkesës për akses në burime gjenetike *ex-situ*, ministria përgjegjëse për mjedisin përcakton nëse aplikimi plotëson kushtet e mëposhtme:

a) veprimtaria është e lejuar nga ligji;

b) janë siguruar të dhëna të plota për personat juridikë dhe fizikë që i kërkojnë materialet dhe për përdorimin e mëvonshëm të tyre;

c) është rënë dakord për kushtet e përdorimit të mëvonshëm të materialeve dhe për ndarjen e përfitimeve, monetare dhe jomonetare, me Republikën e Shqipërisë ose me pronarin privat.

2. Aksesi për sasi të vogla, kryesisht për qëllime kërkimore apo demonstruese, të bimëve, kafshëve, materialit mikrobik, materialit gjenetik apo molekulave të tjera biologjike, të vjela nga burime *ex-situ,* që janë në pronësi apo financim publik, si dhe i të dhënave shoqëruese të tyre, bëhen me marrëveshje për transferimin e materialit të siguruar nga këto burime, nëse kërkesa plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni.

3. Procedura e vlerësimit të kërkesës për akses i nënshtrohet procedurave ligjore për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

4. Aplikimi për akses dhe informacion në burimet gjenetike *ex-situ* realizohet nëpërmjet kërkesës me shkrim pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin, sipas formatit përkatës të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 44/9
Rastet përjashtimore të trajtimit të kërkesës për akses

1. Ministri, me urdhër, mund të miratojë me procedurë të thjeshtuar aksesin dhe informacionin në burime gjenetike për të interesuarit, për qëllime kërkimi jotregtare.

2. Rregullat për aksesin në burimet gjenetike lidhur me ushqimin e bujqësinë dhe rolin e tyre të veçantë për sigurimin e ushqimeve, miratohen me urdhër të përbashkët të ministrit dhe ministrit përgjegjës për bujqësinë, duke mbajtur në konsideratë edhe aktet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

KREU X/III
PRONËSIA, TRANSFERIMI, EKSPORTI DHE PËLQIMI I KOMUNITETIT

Neni 44/10
Pronësia, transferimi dhe eksporti i materialeve gjenetike

1. Materialet e përfituara nga burimet gjenetike, pavarësisht sasisë së tyre, dhe të dhënat shoqëruese, edhe pas përdorimit, mbeten pronë e Republikës së Shqipërisë ose të pronarit nga i cili ato u volën ose janë marrë, në përputhje me përcaktimet e nenit 44/11, të këtij ligji.

2. Pajisja e përdoruesit me certifikatë nuk ndryshon pronësinë e materialeve gjenetike të mbledhura *in-situ* nga veprimtaria kërkimore, por lejon përdorimin e tyre dhe rikthimin e tyre te pronari fillestar, pas përfundimit të veprimtarisë kërkimore, me përjashtim të rasteve kur është vendosur ndryshe, paraprakisht, ndërmjet palëve.

3. Transferimi i materialeve apo të dhënave shoqëruese tek të tretët lejohet në bazë të normave ndërkombëtare, vetëm pas marrjes së miratimit paraprak, të informuar, me shkrim, nga ministria apo pronari privat dhe nënshkrimit të marrëveshjes përkatëse ndërmjet palëve.

4. Ministria përgjegjëse për mjedisin harton formatin e marrëveshjes për transferimin e materialit për përdorim nga të gjitha burimet *ex-situ* në pronësi, e cila miratohet me urdhër të ministrit.

5. Ndalohet eksporti i materialeve apo mostrave të burimeve gjenetike të vjela në mënyrë *in-situ*.

Neni 44/11
Pëlqimi i informuar paraprak nga komuniteti

1. Të gjithë të personat, që duan të kenë akses në dijet, risitë dhe praktikat e komuniteteve vendore në lidhje me burimet gjenetike dhe njohuritë tradicionale, duhet të marrin pëlqimin e informuar, paraprak, nga këto komunitete, duke përcaktuar, paraprakisht, edhe kushtet e dakordësuara me to për ndarjen e përfitimeve nga përdorimi i tyre.

2. Pëlqimi paraprak, i informuar, jepet me shkrim nga komuniteti ose përfaqësuesi i tyre.

3. Të gjitha komunitetet apo personat brenda komuniteteve kanë të drejtë të përfitojnë nga përdorimi tregtar ose jotregtar i dijeve, risive dhe praktikave të tyre në lidhje me burimin gjenetik, si pasojë e afërsisë territoriale.".

Neni 12

Në nenin 49, pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

"1. Për ruajtjen e biodiversitetit dhe të përbërësve të tij, në zbatim të kërkesave të këtij ligji, ushtrojnë kontroll strukturat përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit.

2. Kontrollet shërbejnë për verifikimin e zbatimit të legjislacionit për biodiversitetin, për kontrollin e zbatimit të kushteve të certifikatës së aksesit dhe për marrjen e masave të përcaktuara në këtë ligj.".

Neni 13

Pas nenit 49 shtohen nenet 49/1, 49/2 dhe 49/3 me këtë përmbajtje:

"Neni 49/1
Deklaratat e kontrollit të detajuar të kërkimit shkencor

1. Ministria përgjegjëse për mjedisin është autoriteti kompetent për pajisjen me deklaratë të kontrollit të detajuar ndaj kërkimit shkencor për burimet gjenetike.

2. Deklarata e kontrollit të detajuar ndaj kërkimit shkencor përfitohet nga kërkuesi pas dorëzimit nga ana e tij, pranë ministrisë, të formularit të kërkesës së plotësuar, sipas formatit të miratuar me urdhër të ministrit.

3. Deklarata është një kopje e vetme dhe autentike, që plotësohet vetëm një herë dhe lëshohet përpara se:

a) të kërkohet miratimi apo autorizimi për hedhjen në treg të një produkti të zhvilluar nga shfrytëzimi i burimeve gjenetike dhe njohurive tradicionale të lidhura me burimet gjenetike;

b) të kryhet, paraprakisht, njoftimi, për futjen për herë të parë në tregun shqiptar të një produkti të zhvilluar nga shfrytëzimi i burimeve gjenetike dhe njohurive tradicionale të lidhura me burimet gjenetike;

c) rezultatet e përdorimit t'i shiten apo transferohen çdo personi fizik apo juridik brenda Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që ai person të kryejë njërën prej veprimtarive të shpjeguara në shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike;

ç)të ketë përfunduar shfrytëzimi në Republikën e Shqipërisë dhe rezultatet t'i jenë shitur apo transferuar një personi fizik apo juridik jashtë Republikës së Shqipërisë.

4. Formati i deklaratës së kontrollit të kërkimit shkencor miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për mjedisin.

5. Përdoruesit i japin të dhëna autoritetit kompetent, sipas kërkesës me shkrim të këtij të fundit.

6. Dokumentacioni shoqërues i formularit, afatet dhe procedura e shqyrtimit të kërkesës për pajisje me deklaratë, si dhe deklarata për arritjen e fazës së zhvillimit përfundimtar të kërkimit shkencor, sipas nenit 49/2, të këtij ligji, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 49/2

Deklarata për arritjen e fazës së zhvillimit përfundimtar të kërkimit shkencor

1. Ministria është autoriteti kompetent për pajisjen me deklaratë të zhvillimit përfundimtar të kërkimit shkencor për burimet gjenetike.

2. Deklarata e kontrollit të zhvillimit përfundimtar të kërkimit shkencor përfitohet nga kërkuesi pas dorëzimit nga ana e tij, pranë ministrisë, të formularit të kërkesës, të plotësuar sipas formatit të miratuar me urdhër të ministrit, duke deklaruar se ka përmbushur detyrimet. Njëkohësisht me formularin, kërkuesi duhet të dorëzojë:

a) informacionin përkatës, sipas certifikatës ndërkombëtare të pajtueshmërisë;

b) kur nuk disponon certifikatën e pajtueshmërisë ndërkombëtare, informacionin e mëposhtëm:

i) datën dhe vendin e burimeve gjenetike ose të njohurive tradicionale të lidhura me burimet gjenetike;

ii) përshkrimin e burimeve gjenetike ose të njohurive tradicionale, që lidhen me burimet gjenetike të përdorura;

iii) vendndodhjen, nga e cila gjenerohen burimet gjenetike ose njohuritë tradicionale të lidhura me këto burime, si dhe shfrytëzuesit e këtyre burimeve gjenetike ose njohurive tradicionale të lidhura me to;

iv) praninë ose mungesën e të drejtave dhe detyrimeve në lidhje me aksesin dhe ndarjen e përfitimeve, përfshirë të drejtat dhe detyrimet në lidhje me aplikimet pasuese dhe komercializimin;

v) lejet e aksesit, kur është e aplikueshme;

vi) kushtet e dakordësuara reciprokisht, duke përfshirë marrëveshjet për ndarjen e përfitimeve, aty ku është e aplikueshme.

3. Përdoruesit i japin të dhëna autoritetit kompetent, sipas kërkesës me shkrim të këtij të fundit.

4. Informacionin e mbledhur, ministria përgjegjëse për mjedisin e përditëson në regjistrin e koleksioneve të burimeve gjenetike, referuar dispozitave të këtij ligji, duke ruajtur të dhënat konfidenciale dhe duke respektuar të drejtën e autorit.

5. Formati i deklaratës së kontrollit të kërkimit shkencor dhe formati i deklaratës së zhvillimit përfundimtar të kërkimit shkencor miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 49/3

Ruajtja e konfidencialitetit

1. Kërkuesit, pas lejimit të aksesit, ruajnë konfidencialitetin e informacionit nga kërkimi shkencor dhe të ndarjes së përfitimeve për një periudhë 20-vjeçare pas përfundimit të periudhës së kërkimit.

2. Autoritetet përgjegjëse respektojnë konfidencialitetin e informacionit tregtar apo industrial, në përputhje me parashikimet e legjislacionit kombëtar për mbrojtjen e interesave legjitimë ekonomikë, veçanërisht lidhur me përcaktimin e burimeve gjenetike dhe përdorimin e tyre.".

Neni 14

Në nenin 54, pika 2, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjën "b", fjalët "dhe nuk janë pajisur me leje mjedisore" hiqen.

2. Në shkronjën "d", fjalët "dhe pa leje mjedisore" hiqen.

3. Shkronja "dh" ndryshohet si më poshtë:

"dh) mospajisja me miratimin përkatës të veprimtarive që shfrytëzojnë diversitetin biologjik dhe përbërësit e tij, përfshirë këtu edhe përdorimin e burimeve gjenetike apo të dhënave të dala nga përdorimi i tyre.".

4. Në shkronjën "ë", fjalët "pa leje mjedisore" hiqen.

5. Në shkronjat "f" dhe "g", fjalët "pa leje mjedisore" zëvendësohen me fjalët "miratimin përkatës".

Neni 15

Kudo në tekst, emërtimi "Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave" zëvendësohet me emërtimin "ministria përgjegjëse për bujqësinë" dhe fjalët "pajisen me leje mjedisore" zëvendësohen me fjalët "trajtohen sipas legjislacionit në fuqi për vlerësimit e ndikimin në mjedis".

Neni 16
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, në zbatim të neneve 6, pika 6, e 49/1, pika 6, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja e tij në fuqi.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për mjedisin që, në zbatim të neneve 6, pika 5; 44/4, pika 4; 44/5, pika 3; 44/7, pika 3; 44/8, pika 4; 44/9, pika 2; 44/10, pika 4; 49/1, pika 2; 49/2, pika 5, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, brenda një viti nga hyrja e tij në fuqi.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.4.2020

Shpallur me dekretin nr. 11471, datë 30.4.2020, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11471, datë 30.4.2020

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 41/2020, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit", të ndryshuar".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11467, datë 29.4.2020

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Admir Mark Jaha
2. Eriola (Franka) Frederik Dodo (Agolli)
3. Ersi Franc Dodo
4. Emy Franc Dodo
5. Franc Shefqet Dodo
6. Rebeka Fatmir Mara
7. Muhamed Alfred Zeneli
8. Klodi Panajot Broksch (Duka)
9. Mjaftime Hazbi Marcialis (Qerimi)
10. Gentiana Pavli Nagel (Haxhillazi)

11. Ervin Sherif Halili
12. Erikson Shkurt Loka

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 349, datë 29.4.2020

PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK "PËR PAJISJET ELEKTRIKE TË PROJEKTUARA PËR PËRDORIM BRENDA KUFIJVE TË CAKTUAR TË TENSIONIT" DHE PËRCAKTIMIN E LISTËS SË STANDARDEVE TË HARMONIZUARA [3]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr.10489, datë 15.12.2011, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik "Për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionit" dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara, sipas tekstit që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Standardet e harmonizuara shqiptare, numrat dhe titujt e të cilëve janë përshirë në listën bashkëlidhur këtij vendimi, shërbejnë si dokumente referencë për prezumimin e konformitetit të pajisjeve elektrike me kërkesat thelbësore të objektivave të sigurisë, të përcaktuara në këtë rregull teknik, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. Çdo pajisje elektrike e vendosur në treg para hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe në përputhje me vendimin nr.1061, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullit teknik "Për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit" dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara", nuk do të pengohet të bëhet e disponueshme në treg, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Vendimi nr.1061, datë 23.12.2015, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullit teknik "Për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit" dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara" zbatohet deri në datën e fillimit të efekteve juridike të këtij vendimi.

5. Vendimi nr.1061, datë 23.12.2015, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullit teknik "Për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit" dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara", shfuqizohet.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet juridike pas një viti nga data e hyrjes në fuqi të tij.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

RREGULL TEKNIK
PËR PAJISJET ELEKTRIKE TË PROJEKTUARA PËR PËRDORIM BRENDA KUFIJVE TË CAKTUAR TË TENSIONIT

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITSHME

Neni 1
Objekti dhe Qëllimi

Ky rregull teknik (këtu e në vijim referuar si "rregull") përcakton kërkesat që duhet të përmbushin pajisjet elektrike të projektuara për t'u përdorur brenda kufijve të caktuar të tensionit

[3] *Ky vendim është përafruar pjesërisht me direktivën 2014/35/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e datës 26 shkurt 2014 "Për harmonizimin e legjislacionit të shteteve anëtare në lidhje me pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda kufijve të tensionit".*
Numri CELEX 32014L0035, Numri i "Fletores zyrtare" L 96/357

(këtu e në vijim referuar si "pajisjet elektrike"), për ofrimin e një sigurie më të lartë të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë së personave, kafshëve shtëpiake dhe pronës, duke garatuar funksionimin e tregut të brendshëm.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky rregull zbatohet për pajisjet elektrike, të projektuara për përdorim me një tension brenda kufirit 50 deri në 1000 V për rrymë alternative dhe prej 75 deri në 1500 V për rrymë të vazhduar, përveç pajisjeve dhe fenomeneve/dukurive të listuara në shtojcën I.

2. Ky rregull nuk zbatohet për pajisjet elektrike dhe fenomenet e renditura më poshtë:

a) Pajisjet elektrike për përdorim në mjedise shpërthyese;

b) Pajisjet elektrike për qëllime radiologjike dhe mjekësore;

c) Pjesët elektrike të përdorura në ashensorët për mallra dhe për njerëz;

ç) Matësit e energjisë elektrike;

d) Prizat dhe spinat për përdorim shtëpiak;

dh) Kontrolluesit për mbrojtjen e rrjetit elektrik;

e) Ndërhyrjet radio-elektrike;

ë) Pajisjet specifike elektrike të përdorura në anije, avionë ose hekurudha, të cilat janë në përputhje me dispozitat e sigurisë të hartuara nga organizmat ndërkombëtarë në të cilat aderon shteti shqiptar;

f) Pajisje të ndërtuara me porosi të destinuara për përdorim vetëm nga profesionistët për qëllime hulumtimi dhe zhvillimi.

Neni 3
Përkufizimet

Për qëllime të këtij rregulli, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

a) **"Bërje e disponueshme në treg"** është çdo furnizim të pajisjeve elektrike për shpërndarje, konsumim ose përdorim në tregun shqiptar gjatë një veprimtarie tregtare, me ose pa pagesë;

b)**"Importues",** është çdo person fizik ose juridik i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, i cili importon dhe vendos pajisjet elektrike në tregun e Republikës së Shqipërisë;

c)**"Kthim i produktit",** është çdo masë që synon arritjen e kthimit të pajisjeve elektrike, që janë bërë ndërkohë të disponueshme tek përdoruesi i fundit;

ç) "Markim CE", është markimi, me të cilin prodhuesi tregon se pajisjet elektrike janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm, kur ky legjislacion parashikon fiksimin e këtij markimi.

d) **"Ndalim i tregtimit",** është çdo masë që ka për qëllim, parandalimin në zinxhirin e furnizimit, për bërjen të disponueshme në treg të pajisjes elektrike;

dh) "**Operator ekonomik",** është prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar, importuesi dhe shpërndarësi;

e) **"Prodhues",** është çdo person fizik ose juridik, i cili prodhon pajisje elektrike, ose ka projektuar dhe prodhuar pajisje elektrike dhe i tregton ato pajisje me emrin ose markën e tij tregtare;

ë) "Përfaqësues i autorizuar", është çdo person fizik ose juridik i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, i cili ka akt përfaqësimi nga prodhuesi për të vepruar në emër dhe për llogari të tij në lidhje me detyrat specifike për detyrimet e prodhuesit të parashikuara në këtë rregull;

f) **"Specifikim teknik",** është një dokument që përshkruan kërkesat teknike që një pajisje elektrike duhet të përmbushë;

g) "**Standard i harmonizuar shqiptar**", është një standard shqiptar, që transpozon një standard të harmonizuar evropian, në mbështetje të këtij rregulli, sipas listës së përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Drejtorisë së Pergjithshme të Standardizimit, në bashkërendim me ministritë përgjegjëse dhe/ose me autoritetet e tjera të administratës qendrore. Lista e standardeve të harmonizuara shqiptare ose çdo ndryshim i saj botohen në "Fletoren zyrtare".

gj) "Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut", është Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut.

h) **"Shpërndarës",** është çdo person fizik ose juridik në zinxhirin e furnizimit, përveç prodhuesit ose importuesit, i cili i bën pajisjet elektrike të disponueshme në treg;

i) **"Vendosje në treg",** është bërja e disponueshme për herë të parë e një pajisjeje elektrike në treg;

j) **"Vlerësim i konformitetit",** është procesi që provon nëse një pajisje elektrike i përmbush objektivat e sigurisë të përcaktuara në nenin 4 dhe në shtojcën I, të këtij rregulli.

Neni 4
Bërja e disponueshme në treg dhe objektivat e sigurisë

1. Pajisja elektrike bëhet e disponueshme në treg vetëm nëse është prodhuar në përputhje me praktikat përkatëse inxhinierike në fushën e sigurisë të Republikës së Shqipërisë dhe nuk rrezikon shëndetin dhe sigurinë e njerëzve, kafshëve shtëpiake ose pronës, kur instalohet, mirëmbahet dhe përdoret sipas qëllimit për të cilin është prodhuar.

2. Kërkesat thelbësore të objektivave të sigurisë janë listuar në shtojcën I, të këtij rregulli (këtu e në vijim referuar si "Objektivat e sigurisë").

Neni 5
Lëvizja e lirë

Në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk ndalohet, për aspekte që mbulohen nga ky rregull, bërja e disponueshme në treg e pajisjes elektrike, që është në përputhje me kërkesat e këtij rregulli.

Neni 6
Furnizimi me energji elektrike

Furnizuesit e energjisë elektrike, për lidhjen e pajisjeve elektrike me rrjetin elektrik ose furnizimin me energji elektrike për konsumatorët që i përdorin këto pajisje, nuk mund të vendosin kërkesa sigurie më të rrepta sesa objektivat e sigurisë të përcaktuara në nenin 4 dhe shtojcën I, të këtij rregulli.

KREU II
DETYRIMET E OPERATORËVE EKONOMIKË

Neni 7
Detyrime e prodhuesve

1. Kur prodhuesi vendos pajisjet elektrike në treg, ai siguron se ato janë projektuar dhe prodhuar në përputhje me objektivat e sigurisë.

2. Prodhuesi harton dokumentacionin teknik të referuar në shtojcën II dhe kryen procedurën e vlerësimit të konformitetit të përcaktuar në po atë shtojcë. Kur përputhshmëria e pajisjeve elektrike me objektivat e sigurisë është demonstruar nga procedura e vlerësimit të konformitetit, prodhuesi harton deklaratën EU të konformitetit dhe fikson markimin CE.

3. Prodhuesi ruan dokumentacionin teknik të përcaktuar në shtojcën II, të këtij rregulli, dhe deklaratën e konformitetit EU, për 10 vjet pasi pajisjet elektike të jenë vendosur në treg.

4. Prodhuesi siguron se zbatohen procedurat e nevojshme që prodhimi në seri i pajisjeve elektrike të mbetet në konformitet, në përputhje me këtë rregull. Ndryshimet në projektimin ose karakteristikat e produktit dhe ndryshimet në standardet e harmonizuara shqiptare, standardet ndërkombëtare ose kombëtare të referuara në nenin 13, të këtij rregulli, ose në specifikimet e tjera teknike sipas të cilave është deklaruar konformiteti i pajisjeve elektrike, duhet merren në konsideratë.

Kur prodhuesi dyshon se pajisja elektrike që ai ka vendosur në treg mund të paraqesë rrrezik për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve, kryen testime të mostrave të pajisjeve elektrike të bëra të disponueshme në treg, heton dhe, nëse është e nevojshme, mban një regjistër të ankesave për pajisjet elektrike që nuk janë në konformitet dhe ato të kthyera nga përdoruesi i fundit, si dhe mban të informuar shpërndarësin për çdo monitorim të tillë.

5. Prodhuesi siguron që pajisja elektrike e vendosur në treg prej tij ka të shënuar tipin, serinë ose numrin serial ose element tjetër që lejon identifikimin e asaj pajisjeje, ose kur madhësia ose natyra e pajisjes elektrike nuk e mundëson atë, informacioni i kërkuar vendoset në paketimin ose në dokumentet shoqëruese të pajisjes elektrike.

6. Prodhuesi vendos në pajisjen elektrike emrin e tij, emrin e regjistruar tregtar ose markën tregtare dhe adresën postare në të cilën ai mund të kontaktohet ose, kur ky informacion nuk mund të vendoset në pajisje, prodhuesi i vendos ato në paketimin ose dokumentet shoqëruese të saj. Adresa duhet të tregojë një pikë të vetme kontakti në të cilën mund të kontaktohet prodhuesi. Të dhënat për adresën duhet të jenë në gjuhën zyrtare të Republikës së Shqipërisë ose në një gjuhë lehtëisht të kuptueshme për përdoruesit e fundit

dhe strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

7. Prodhuesi siguron që pajisja elektrike të shoqërohet nga udhëzimet për përdorimin, dhe, sipas rastit, mirëmbajtjen si dhe nga informacioni për sigurinë në gjuhën shqip. Udhëzuesit dhe informacioni i sigurisë, si dhe çdo etiketim tjetër duhet të jenë të qarta, të lexueshme dhe lehtësisht të kuptueshme.

8. Prodhuesi që konsideron ose ka arsye për të besuar se pajisja elektrike që ka vendosur në treg nuk është në përputhje me këtë rregull duhet që menjëherë të marrë masat e nevojshme korrigjuese për ta sjellë pajisjen elektrike në përputhshmëri, ose, sipas rastit, të ndalojë tregtimin apo ta kthejë atë nga tregu. Kur pajisja elektrike paraqet rrezik, prodhuesi informon menjëherë strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, duke i dhënë hollësitë, në veçanti për mospërputhshmërinë dhe për çdo masë korrigjuese të marrë.

9. Prodhuesi, me kërkesë të arsyetuar të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, i siguron asaj të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm në letër ose formë elektronike, për demonstrimin e konformitetit të pajisjes elektrike të përcaktuar me këtë rregull, në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për këtë strukturë. Prodhuesi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për çdo masë të marrë për eleminimin e rrezikut të shfaqur nga pajisja elektrike e vendosur në treg prej tij.

Neni 8
Detyrimet e përfaqësuesit të autorizuar

1. Prodhuesi, me një akt përfaqësimi, mund të caktojë një përfaqësues të autorizuar. Detyrimet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 7, dhe detyrimi për të hartuar dokumentacion teknik, të referuar në pikën 2, të nenit 7, të këtij rregulli, nuk mund të jenë pjesë e aktit të përfaqësimit.

2. Përfaqësuesi i autorizuar kryen detyrat e përcaktuara në aktin e përfaqësimit, të lëshuar nga prodhuesi. Akti i përfaqësimit duhet të lejojë përfaqësuesin e autorizuar të kryej së paku:

a) të ruaj/mbaj deklaratën EU të konformitetit dhe dokumentacionin teknik në dispozicion të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për 10 vjet nga vendosja e pajisjes elektrike në treg;

b) t'i sigurojë strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, në rast të një kërkese të arsyetuar nga ana saj, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për demonstrimin e përputhshmërisë së pajisjes elektrike;

c) të bashkëpunojë me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, sipas kërkesës së bërë nga ana e saj, për marrjen e masave për eliminimin e rreziqeve të shfaqura nga pajisja elektike, për të cilën i është lëshuar akti i përfaqësimit.

Neni 9
Detyrimet e importuesit

1. Importuesi vendos në tregun shqiptar vetëm pajisje elektrike në përputhje me këtë rregull dhe legjislacionin e zbatueshëm në fuqi.

2. Para vendosjes së pajisjes elektrike në treg, importuesi sigurohet që:

a) prodhuesi i ka kryer procedurat e duhura të vlerësimit të konformitetit dhe ka hartuar dokumentacionin teknik,

b) pajisja elektrike ka markimin CE dhe shoqërohet me dokumentet e kërkuara, dhe se,

c) prodhuesi ka përmbushur kërkesat e përcaktuara, pikat 5 dhe 6, të nenit 7, të këtij rregulli.

3. Kur importuesi konsideron ose ka arsye të besojë se pajisja elektrike që ai importon nuk është në përputhje me objektivat e sigurisë, ai nuk duhet të vendosë pajisjen elektrike në treg, derisa ta sjellë në konformitet. Kur pajisja elektrike paraqet rrezik, importuesi informon prodhuesin dhe strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

4. Importuesi vendos në pajisjen elektrike emrin e tij, emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar dhe adresën postare ku mund të kontaktohet, ose, kur ky informacion nuk është imundur të vendoset në pajisje, importuesi i vendos ato në paketimin ose dokumentet shoqëruese të saj. Të dhënat mbi adresën duhet të jenë në gjuhën zyrtare të Republikës së Shqipërisë ose në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për përdoruesit e fundit dhe strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

5. Importuesi siguron që pajisja elektrike të shoqërohet nga udhëzimet për përdorimin ose, sipas rastit, udhëzimet për mirëmbajtjen, si dhe nga informacioni për sigurinë në gjuhën zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Udhëzuesit dhe informacioni i sigurisë, si dhe çdo etiketim tjetër

duhet të jenë të qarta, të lexueshmë dhe lehtësisht të kuptueshme.

6. Importuesi siguron që gjatë kohës që pajisja elektrike është nën përgjegjësinë e tij, kushtet e magazinimit ose të transportit nuk e rrezikojnë përputhshmërinë e pajisjes elektrike me objektivat e sigurisë.

7. Kur importuesi dyshon se pajisja elektrike që ai ka bërë të disponueshme në treg mund të paraqesë rrezik për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve, kryen testime të mostrave të pajisjeve elektrike të bëra të disponueshme në treg, heton dhe, nëse është e nevojshme, mban një regjistër ankesash për pajiset elektrike që nuk janë në konformitet dhe pajisjeve elektrike të kthyera nga konsumatori ose përdoruesi i fundit, si dhe informon shpërndarësin për çdo monitorim të tillë.

8. Importuesi, i cili konsideron ose ka arsye për të besuar se pajisja elektrike, të cilin ai e ka vendosur në treg, nuk është në përputhje me këtë rregull, duhet menjëherë të marrë masat e nevojshme korrigjuese për ta sjellë atë pajisje elektrike në konformitet, ose sipas rastit, të ndalojë tregtimin apo ta kthejë atë nga tregu. Kur pajisja elektrike shfaq rrezik, importuesi informon menjëherë strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, duke i dhënë hollësi, në veçanti për mospërputhshmërinë dhe për çdo masë korrigjuese të marrë.

9. Importuesi mban deklaratën e konformitetit dhe dokumentacionin teknik në dispozicion të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për 10 vjet pas vendosjes së pajisjes elektrike në treg, dhe siguron që dokumentacioni teknik mund tu vihet në dispozicion strukturave të tilla sipas kërkesës.

10. Importuesi, me kërkesë të arsyetuar të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, i siguron atyre të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm në letër ose në formë elektronike, për demonstrimin e konformitetit të pajisjes elektrike në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për këte strukturë. Importuesi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për çdo masë të marrë për eliminimin e rrezikut të shfaqur nga pajisja elektrike e vendosur në treg prej tij.

Neni 10
Detyrimet e shpërndarësit

1. Kur pajisja elektrike bëhet e disponueshme në treg, shpërndarësi duhet të veprojë me kujdesin e duhur në lidhje me respektimin e kërkesave të këtij rregulli.

2. Para bërjes së disponueshme në treg të pajisjes elektrike, shpërndarësi verifikon që:

a) pajisja elektike mban markimin CE të konformitetit,

b) pajisja elektrike shoqërohet me dokumentacionin e kërkuar, udhëzimet dhe informacionin për sigurinë në gjuhën zyrtare të Republikës së Shqipërisë, dhe që,

c) prodhuesi dhe importuesi kanë plotësuar kërkesat e parashikuara në pikat 5 dhe 6, të nenit 7, dhe në pikën 4, të nenit 9, të këtij rregulli.

3. Kur shpërndarësi konsideron ose ka arsye për të besuar se pajisja elektrike nuk është në konformitet me objektivat e sigurisë, ai nuk duhet të bëjë të disponueshme në treg pajisjen elektrike, derisa ajo të sillet në konformitet me kërkesat ligjore të zbatueshme për të. Kur pajisja elektrike shfaq rrezik, shpërndarësi informon prodhuesin ose importuesin për rrezikun, si dhe strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

4. Shpërndarësi, siguron se, gjatë kohës kur pajisja është nën përgjegjësinë e tij, kushtet e magazinimit ose të transportit nuk e rrezikojnë përputhshmërinë e tij me objektivat e sigurisë.

5. Shpërndarësi, i cili konsideron ose ka arsye për të besuar se pajisja elektrike, të cilën ai e ka bërë të disponueshme në treg, nuk është në përputhje me këtë rregull, siguron, marrjen e masave korrigjuese për sjelljen e pajisjes elektrike në në konformitet, ose sipas rastit ndalimin e tregtimit ose kthimin e saj. Kur pajisja elektrike paraqet rrezik, shpërndarësi informon menjëherë strukturën përgjegjëse për mbikqyrjen e tregut, duke i dhënë hollësi, në veçanti për mospërputhshmërinë dhe për çdo masë korrigjuese të marrë.

6. Me kërkesë të arsyetuar të strukturës përgjegjëse, shpërndarësi i siguron asaj të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të demonstruar përputhshmërinë e pajisjes elektrike. Shpërndarësi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse, sipas kërkesës së saj, për çdo masë të marrë për eliminimin e rrezikut të shfaqur nga

pajisja elektrike e bërë e disponueshme në treg prej tij.

Neni 11
Rastet në të cilat detyrimet e prodhuesit zbatohen për importuesin dhe shpërndarësin

Importuesi ose shpërndarësi konsiderohet prodhues, për qëllime të këtij rregulli dhe i nënshtrohet detyrimeve të prodhuesit sipas nenit 7, kur ai vendos një pajisje elektrike në treg nën emrin ose markën e tij tregtare, ose, modifikon pajisjen elektrike të vendosur tashmë në treg në mënyrë të tillë që të ndikojë në përputhshmërinë e saj me kërkesat e përcaktuara në këtë rregull.

Neni 12
Identifikimi i operatorëve ekonomik

1. Operatorët ekonomikë, sipas kërkesës së strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut identifikojnë:

a) çdo operator ekonomik i cili i ka furnizuar ata me pajisje elektrike;

b) çdo operator ekonomik të cilin ata e kanë furnizuar me pajisje elektrike.

2. Operatorët ekonomikë duhet të jenë në gjendje të paraqesin informacionin e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, për 10 vjet pasi janë furnizuar me pajisjet elektrike dhe për 10 vjet pasi kanë furnizuar me pajisjet elektrike.

KREU III
PËRPUTHSHMËRIA E PAJISJEVE ELEKTRIKE

Neni 13
Prezumimi i konformitetit në bazë të standardeve

1. Pajisja elektrike që është në përputhje me standardet e harmonizuara shqiptare ose pjesë të tyre, referencat e të cilave janë publikuar në "Fletoren zyrtare", prezumohet se është në përputhje me objektivat e sigurisë, të referuara në nenin 4 dhe të përcaktuara shtojcën I, të këtij rregulli, mbuluar nga ato standarde ose pjesë të tyre.

2. Kur standardet e harmonizuara shqiptare nuk janë hartuar dhe publikuar, pajisjet elektrike konsiderohen se janë në përputhje me objektivat e sigurisë për qëllime të bërjes së disponueshme në treg ose lëvizjes së lirë, nëse janë në përputhje me dispozitat e sigurisë të standardeve ndërkombëtare të përcaktuara nga Komisioni Ndërkombëtar Elektroteknik (KNE).

3. Kur standardet e harmonizuara shqiptare nuk janë hartuar dhe publikuar dhe standardet ndërkombëtare të përcaktuara nga KNE-ja nuk janë publikuar, pajisja elektrike konsiderohet se është në përputhje me objektivat e sigurisë për qëllime të bërjes së disponueshme në treg ose lëvizjes së lirë vetëm nëse është në përputhje me dispozitat e sigurisë të standardeve në fuqi në shtetin ku është prodhuar dhe siguron një nivel sigurie të njëjtë me atë që parashikohet në këtë rregull.

Neni 14
Deklarata EU e konformitetit

1. Deklarata EU e konformitetit provon se është demonstruar përmbushja e objektivave të sigurisë të përcaktuar në këtë rregull.

2. Deklarata EU e konformitetit hartohet sipas formës së përcaktuar në Shtojcën III të këtij rregull. Ajo përmban elementet e specifikuara në Modulin A të shtojcës II, të këtij rregulli, dhe përditësohet vazhdimisht. Deklarata EU e konformitetit përkthehet në gjuhën shqipe ose në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme nga përdoruesi i fundit dhe nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

3. Kur pajisja elektrike është objekt i zbatimit të më shumë se një akti ligjor apo nënligjor që kërkon hartimin e deklaratës EU të konformitetit, për të gjitha këto akte hartohet një deklaratë e vetme EU konformiteti. Deklarata duhet të përmbajë identifikimin e akteve ligjore të zbatueshme, duke përfshirë referencat e tyre të botimit.

4. Me hartimin e deklaratës EU të konformitetit, prodhuesi merr përsipër përgjegjësinë për përputhshmërinë e pajisjes elektrike me kërkesat e përcaktuara në këtë rregull.

Neni 15
Parimet e përgjithshme, rregullat dhe kushtet e markimit ce

1. Markimi CE i pajisjes elektrike kryhet sipas parimeve të përgjithshme të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregute të produkteve joushqimore.

2. Markimi CE vendoset në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paheqshme në çdo pajisje elektrike ose në paketim, në dokumentin hyrës ose në çertifikatën e garancisë së saj.

3. Markimi CE duhet të vendoset para se pajisja elektrike të vendoset në treg.

4. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, në bashkëpunim me autoritetet doganore, sigurojnë aplikimin korrekt të regjimit që rregullon markimin CE dhe ndërmarrin veprimet e duhura në rast të përdorimit të papërshtatshëm të këtij markimi, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

KREU IV
MBIKËQYRJA E TREGUT DHE KONTROLLI I PAJISJEVE ELEKTRIKE QË HYJNË NË TREG

Neni 16
Mbikëqyrja e tregut dhe kontrolli i pajisjeve elektrike që hyjnë në treg

Mbikëqyrja e tregut dhe kontrolli i pajisjeve elektrike që hyjnë në treg kryhet nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Neni 17
Procedura për trajtimin e pajisjeve elektrike që paraqesin rrezik në nivel kombëtar

1. Kur struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut ka arsye të mjaftueshme për të besuar se pajisjet elektrike, të mbuluara nga ky rregull, paraqesin rrezik për shëndetin ose sigurinë e personave ose kafshëve shtëpiake ose pronës, ato duhet të kryejnë një vlerësim në lidhje me pajisjen elektrike në fjalë në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë rregull. Për këtë qëllim, operatorët përkatës ekonomik duhet të bashkëpunojnë sipas nevojës me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

2. Kur, gjatë vlerësimit të kryer sipas pikës 1, të këtij neni, struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut konstaton se pajisja elektrike nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë rregull, kërkon pa vonesë nga operatori përkatës ekonomik, që të marrë të gjitha veprimet e duhura korrigjuese, për të sjellë pajisjen elektrike në përputhje me këto kërkesa, të ndalojë tregtimin e pajisjes elektrike, ose të kthejë pajisjen nga përdoruesi i fundit brenda një periudhe të arsyeshme, në përpjesëtim me natyrën e rrezikut që paraqitet.

3. Veprimet korrigjuese të përmendura pikën 2, të këtij neni, merren në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

4. Operatori ekonomik duhet të sigurojë që të ndërmerren të gjitha veprimet e duhura korrigjuese në lidhje me pajisjen elektrike në fjalë që ai ka bërë të disponueshme në treg.

5. Kur operatori përkatës ekonomik nuk merr masat e duhura korrigjuese brenda periudhës së referuar në pikën 2, të këtij neni, struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut merr të gjitha masat e përkohshme të përshtatshme për të ndaluar ose kufizuar bërjen të disponueshme në treg të pajisjes elektrike, apo për ndalimin e tregtimit ose për kthimin e pajisjes nga përdoruesi i fundit.

Neni 18
Pajisjet elektrike në përputhje por që paraqesin rrezik

1. Kur struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, pas vlerësimit të bërë sipas pikës 1, të nenit 17, të këtij rregulli, konstaton se edhe pse pajisja elektrike është në përputhje me këtë rregull, ajo paraqet rrezik për shëndetin ose sigurinë e personave, apo kafshëve shtëpiake ose pronës, operatori përkatës ekonomik duhet të marrë të gjitha masat e duhura për të siguruar që pajisja elektrike në fjalë, e vendosur në treg të mos paraqesë rrezik, të ndalojë tregtimin e pajisjes elektrike, ose të kthejë pajisjen nga përdoruesi i

fundit brenda një periudhe të arsyeshme, në përpjesëtim me natyrën e rrezikut që paraqitet.

2. Operatori ekonomik siguron që të ndërmerren veprime korrigjuese në lidhje me të gjitha pajisjet elektrike që ai ka bërë të disponueshme në treg.

Neni 19
Mospërputhshmëria formale

1. Pa përjashtuar parashikimet e nenit 18, të këtij rregulli, struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut i kërkon operatorit përkatës ekonomik t'i japë fund mospërputhjes në fjalë kur konstaton një nga rastet e mëposhtme:

a) markimi CE është fiksuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore ose nenit 15, të këtij rregulli;

b) markimi CE nuk është fiksuar;

c) deklarata e EU e konformitetit nuk është hartuar;

ç) deklarata e EU e konformitetit nuk është hartuar në mënyrë korrekte;

d) dokumentacioni teknik nuk është i disponueshëm ose jo i plotë;

dh) informacioni i përmendur në pikën 6, të nenit 7, ose në pikën 5, të nenit 9, mungon, është i rremë ose jo i plotë;

e) nuk plotësohen kërkesat e tjera administrative të parashikuara në nenet 7 dhe 9, të këtij rregulli.

2. Kur mospërputhja formale vazhdon, struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut duhet të marrë të gjitha masat e duhura për të kufizuar ose ndaluar pajisjet elektrike që jane bërë të disponueshme në treg ose për të siguruar që ato të rivlerësohen ose të ndalohet tregtimi ose të kthehen nga përdoruesi i fundit.

Neni 20
Kundërvajtjet administrative

Shkeljet e kërkesave të këtij rregulli nga operatorët ekonomikë trajtohen sipas legjislacionit në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

SHTOJCA I

1. Kushtet e përgjithshme

a) karakteristikat thelbësore, njohja dhe mbajtja parasysh e të cilave do të sigurojë që pajisja elektrike përdoret në mënyrë të sigurtë për destinacionin për të cilin është prodhuar, shënohen në pajisjet elektrike ose, nëse kjo nuk është e mundur, në një dokument shoqërues;

b) pajisja elektrike, së bashku me pjesët përbërëse të saj, duhet të prodhohen në atë mënyrë që të montohen dhe lidhen në mënyrë të sigurtë dhe të rregullt;

c) pajisja elektrike duhet të projektohet dhe prodhohet në atë mënyrë që të sigurojë mbrojtjen nga rreziqet e dhëna në pikat 2 dhe 3, me kushtin që pajisja të përdoret për qëllimin që është prodhuar dhe mirëmbahet si kërkohet sipas instruksioneve të prodhuesit.

2. Mbrojtja nga rreziqet që dalin nga pajisja elektrike

Masat e një natyre teknike teknike duhet të përshkruhen në përputhje me pikën 1 në mënyrë që të sigurojnë që:

a) personat dhe kafshët shtëpiake janë mjaftueshmërisht të mbrojtur nga çdo rrezik lidhur me dëmtimin fizik ose çdo rrezik që mund të shkaktohet nga kontakti i drejtpërdrejtë ose i tërthortë,

b) të mos kenë temperatura, qark elektrik ose rrezatim që mund të shkaktojë një rrezik,

c) personat, kafshët shtëpiake dhe prona të jenë mjaftueshmërisht të mbrojtur nga rreziqe të natyrës jo elektrike, të shkaktuara nga pajisja elektrike dhe të konstatuara nga përvoja,

d) izolimi të jetë i përshtatshëm për kushtet e parashikuara.

3. Mbrojtja nga rreziqet që mund të shkaktohen nga faktorët e jashtëm mbi pajisjen elektrike

Masat teknike të përshkruara në përputhje me pikën 1 duhet të sigurojnë që:

a) pajisja elektrike plotëson kërkesat e parashikuara mekanike në atë mënyrë që personat, kafshët shtëpiake dhe prona te mos jenë të rrezikuara, plotëson kërkesat e pritshme mekanike në mënyrë të tillë që personat, kafshët shtëpiake dhe pronat të mos jenë të rrezikuara;

b) pajisja elektrike të jetë rezistente ndaj ndikimeve jo mekanike që brenda kushteve të parashikuara të mjedisit të mos rrezikohen personat, kafshët shtëpiake dhe prona,

c) pajisja elektrike nuk duhet të rrezikojë personat, kafshët shtëpiake dhe pronën në kushte të parashikuara të mbingarkesës.

SHTOJCA II

Moduli A

1. Kontrolli i brendshëm i prodhimit

Kontrolli i brendshëm i prodhimit është procedura e vlerësimit të konformitetit, me të cilën prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4 të kësaj shtojce dhe siguron dhe deklaron, me përgjegjësi të plotë, që pajisja elektrike plotëson kërkesat e këtij rregulli të zbatueshëm.

2. Dokumentacioni teknik

Prodhuesi duhet të krijojë dokumentacionin teknik. Dokumentacioni duhet të bëjë të mundur vlerësimin e përputhshmërisë së pajisjes elektrike me kërkesat përkatëse dhe duhet të përfshijë një analizë adekuate dhe vlerësim të riskut.

Dokumentacioni teknik specifikon kërkesat e zbatueshme dhe mbulon, sa i përket vlerësimit, projektimin, prodhimin dhe funksionimin e pajisjes elektrike.

Dokumentacioni teknik, kur është e zbatueshme, përmban të paktën elementët e mëposhtëm:

a) një përshkrim të përgjithshëm të pajisjes elektrike;

b) konceptin e dizenjimit/projektimit dhe skicat e komponenteve, pjesëve, qarqeve, etj.

c) përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme për kuptimin e vizatimeve, skemave dhe funksionimin e pajisjes elektrike;

d) një listë të standardeve të harmonizuara që zbatohen plotësisht ose pjesërisht, referencat e të cilave janë publikuar në Fletoren Zyrtare ose standardet ndërkombëtare apo kombëtare të referuara në nenin 13 dhe, kur këto standarde të harmonizuara ose ndërkombëtare ose standardet kombëtare nuk aplikohen, përshkrimet e zgjidhjeve të miratuara për të përmbushur objektivat e sigurisë të këtij rregulli, duke përfshirë një listë të specifikimeve të tjera teknike të aplikuara. Në rast të standardeve të harmonizuara të aplikuara pjesërisht ose standardeve ndërkombëtare ose kombëtare të referuara në nenin 13 dokumentacioni teknik specifikon pjesët që janë zbatuar;

e) rezultatet e llogaritjeve të projektimit të bëra, testimet e kryera, etj; dhe

f) raportet e testimit.

3. Prodhimi

Prodhuesi merr të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojnë përputhjen e pajisjes elektrike të prodhuar me dokumentacionin teknik të përmendur në pikën 2 dhe me kërkesat e këtij rregulli të zbatueshëm për të.

4. Markimi CE dhe deklarata e EU e konformitetit

4.1. Prodhuesi vendos markimi CE në çdo pajisje elektrike individuale që plotëson kërkesat e zbatueshme të këtij rregulli.

Markimi CE i konformitetit përbëhet nga inicialet CE në formën e mëposhtme:



a) Përmasat e vizatimit të shkallëzuar më lart duhet të respektohen nëse markimi CE zvogëlohet ose zmadhohet,

b) Komponentët e ndryshueshëm të markimit CE duhet të kenë të njëjtën përmasë vertikale, e cila nuk mund të jetë më e vogël se 5 mm.

4.2. Prodhuesi harton me shkrim një deklaratë EU konformiteti për çdo model të produktit dhe e mban atë së bashku me dokumentacionin teknik në dispozicion të autoriteteve kombëtare të mbikëqyrjes së tregut për 10 vjet nga data e vendosjes së pajisjeve elektrike në treg. Deklarata EU e konformitetit identifikon pajisjen elektrike për të cilën është hartuar.

Një kopje e deklaratës EU të konformitetit vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse të mbikëqyrjes së tregut sipas kërkesës.

5. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikën 4 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, në emër dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që ato të specifikohen në autorizimin përkatës.

SHTOJCA III

DEKLARATA EU E KONFORMITETIT (No XXXX)

1. Modeli i pajisjes elektrike (produkti, tipi, numri i serisë):

2. Emri dhe adresa e prodhuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar:

3. Kjo deklaratë e konformitetit lëshohet nën përgjegjësinë e plotë të prodhuesit.

4. Objekti i deklaratës (identifikimi i pajisjes elektrike që lejon gjurmueshmërinë e saj, nëse është e nevojshme mund të përmbajë një imazh me ngjyra dhe mjaftueshmërisht të qartë për identifikimin e pajisjes elektrike):

5. Objekti i deklaratës së përshkruar më sipër është në përputhje me legjislacionin në fuqi të fushës:

6. Referencat e përdorura për standardet përkatëse të harmonizuara ose referencat ndaj specifikimeve të tjera teknike në lidhje me të cilat është deklaruar konformiteti:

7. Informacion shtesë:

Nënshkruar për dhe në emër të:

(vendi dhe data e lëshimit):

(emri, funksioni) (nënshkrimi):

LISTA E STANDARDEVE TË HARMONIZUARA

Direktiva - 2014/35/EU - Për pajisjet elektrike të projektuara për tu përdorur brenda disa kufijve tensioni

NR.	**Referenca dhe titulli i standardit të harmonizuar (dhe dokumenti i referencës)**	**Titulli i standardit në shqip**	**Viti i adoptimit si SSH**	**Mënyra e adoptimit** (me faqe të parë FP ose me përkthim të plotë PP)
	EN 13637:2015 Building hardware - Electrically controlled exit systems for use on escape routes - Requirements and test methods	SSH EN 13637:2015 Materiale ndërtimi - Sisteme dalje të kontrolluara elektrikisht për përdorim në rrugët e daljes emergjente - Kërkesat dhe metodat e provës	2015	Fp
	HD 308 S2:2001 Identification of cores in cables and flexible cords	SSH HD 308 S2:2001 Identifikimi i bërthamave në kabllot dhe kordonët fleksibël	2009	Fp
	HD 361 S3:1999 System for cable designation	SSH HD 361 S3:1999 Sistemet për projektimin e kabllove	2009	Fp
	HD 361 S3:1999/A1:2006	SSH HD 361 S3:1999/A1:2006		Fp
	HD 361 S3:1999/AC:1999	SSH HD 361 S3:1999/AC:1999	2011	Fp
	HD 368 S1:1978 Direct acting recording electrical measuring instruments and their accessories	SSH HD 368 S1:1978 Instrumente matëse elektrike që regjistrojnë direkt veprimin dhe pajisjet ndihmëse të tyre	2009	Fp
	HD 549 S1:1989 Conference systems - Electrical and audio requirements	SSH HD 549 S1:1989 Sisteme për konferenca - Kërkesat elektrike dhe të zërit	2008	Fp
	HD 603 S1:1994 Distribution cables of rated voltage	SSH HD 603 S1:1994 Kabllot e shpërndarjes me tension të	2009	Fp

	0,6/1 kV	vlerësuar 0,6/1 kV		
	HD 603 S1:1994/A1:1997	SSH HD 603 S1:1994/A1:1997		Fp
	HD 603 S1:1994/A2:2003	SSH HD 603 S1:1994/A2:2003		Fp
	HD 603 S1:1994/A3:2007	SSH HD 603 S1:1994/A3:2007		Fp
	HD 604 S1:1994 0,6/1 kV and 1,9/3,3 kV power cables with special fire performance for use in power stations	SSH HD 604 S1:1994 Kabllot e fuqisë 0,6/1 kV dhe 1,9/3,3 kV me performancë speciale ndaj zjarrit për përdorim në stacionet elektrike	2009	Fp
	HD 604 S1:1994/A1:1997	SSH HD 604 S1:1994/A1:1997		Fp
	HD 604 S1:1994/A2:2002	SSH HD 604 S1:1994/A2:2002		Fp
	HD 604 S1:1994/A3:2005	SSH HD 604 S1:1994/A3:2005		Fp
	HD 605 S2:2008 Electric cables - Additional test methods	SSH HD 605 S2:2008 Kabllot elektrik - Metodat shtesë të provës	2009	Fp
	HD 605 S2:2008/AC:2010	SSH HD 605 S2:2008/AC:2010	2011	Fp
	HD 626 S1:1996 Overhead distribution cables of rated voltage Uo/U(Um): 0,6/1 (1,2) kV	SSH HD 626 S1:1996 Kabllo ajror të shpërndarjes me tension të vlerësuar Uo/U(Um): 0,6/1 (1,2) kV	2009	Fp
	HD 626 S1:1996/A1:1997	SSH HD 626 S1:1996/A1:1997		Fp
	HD 626 S1:1996/A2:2002	SSH HD 626 S1:1996/A2:2002		Fp
	HD 627 S1:1996 Multicore and multipair cables for installation above and below ground	SSH HD 627 S1:1996 Kabllo shumëbërthamëshe dhe shumëpalëshe për instalim nëntokësor dhe mbitokësor	2009	Fp
	HD 627 S1:1996/A1:2000	SSH HD 627 S1:1996/A1:2000		Fp
	HD 627 S1:1996/A2:2005	SSH HD 627 S1:1996/A2:2005		Fp
	HD 639 S1:2002 Electrical accessories - Portable residual current devices without integral overcurrent protection for household and similar use	SSH HD 639 S1:2002 Pajisje ndihmëse elektrike - Aparatet portative matëse të rrymës mbetëse pa mbrojtje integrale ndaj mbirrymës për pajisjet elektrike shtëpiake dhe të ngjashme me to (PRCDs)	2009	Fp
	HD 639 S1:2002/A1:2003	SSH HD 639 S1:2002/A1:2003		Fp
	HD 639 S1:2002/A2:2010	SSH HD 639 S1:2002/A2:2010	2011	Fp
	HD 639 S1:2002/AC:2003	SSH HD 639 S1:2002/AC:2003		Fp
	EN 50065-4-2:2001 Signalling on low-voltage electrical installations in the frequency range 3 kHz to 148,5 kHz and 1,6 MHz to 30 MHz - Part 4-2: Low voltage decoupling filters - Safety requirements	SSH EN 50065-4-2:2001 Sinjalizues për instalimet elektrike të tensionit të ulët në intervalin e frekuencave 3 - 148.5 kHz - Pjesa 4-2: Filtrat e stakimit në tension të ulët - Kërkesat e sigurisë	2006	Fp
	EN 50065-4-2:2001/A1:2003	SSH EN 50065-4-2:2001/A1:2003	2008	Fp
	EN 50065-4-2:2001/A2:2005	SSH EN 50065-4-2:2001/A2:2005		Fp
	EN 50065-4-7:2005 Signalling on low-voltage electrical installations in the frequency range 3 kHz to 148,5 kHz and 1,6 MHz to 30 MHz - Part 4-7: Portable low voltage decoupling filters - Safety requirements	SSH EN 50065-4-7:2005 Sinjalizues për instalimet elektrike të tensionit të ulët në intervalin e frekuencave 3-148.5 kHz - Pjesa 4-7: Filtrat e stakimit në tension të ulët të transportueshme - Kërkesat e sigurisë	2007	Fp
	EN 50065-4-7:2005/AC:2006	SSH EN 50065-4-7:2005/AC:2006	2011	Fp

	EN 50085-1:2005 Cable trunking systems and cable ducting systems for electrical installations - Part 1: General requirements	SSH EN 50085-1:2005 Sisteme kabllore të linjës lidhëse dhe kanalizimeve për instalimet elektrike - Pjesa 1: Kërkesa të përgjithshme	2008	Fp
	EN 50085-1:2005/A1:2013	SSH EN 50085-1:2005/A1:2013	2014	Fp
	EN 50085-2-1:2006 Cable trunking systems and cable ducting systems for electrical installations - Part 2-1: Cable trunking systems and cable ducting systems intended for mounting on walls and ceilings	SSH EN 50085-2-1:2006 Sistemet kabllore të linjës lidhëse dhe kanalizimeve për instalimet elektrike - Pjesa 2-1: Sistemet kabllore të linjës lidhëse dhe kanalizimeve të parashikuar për montimin në murr dhe tavan	2008	Fp
	EN 50085-2-1:2006/A1:2011	SSH EN 50085-2-1:2006/A1:2011	2012	Fp
	EN 50085-2-2:2008 Cable trunking systems and cable ducting systems for electrical installations - Part 2-2: Particular requirements for cable trunking systems and cable ducting systems intended for mounting underfloor, flushfloor, or onfloor	SSH EN 50085-2-2:2008 Sistemi i kanalinave për kabllo dhe sistemet me tuba për kabllo për instalime elektrike - Pjesa 2-2: Kërkesa të veçanta për sistemet e kanalinave për kabllo dhe sistemet me tuba për kabllo të paracaktuara për montim nën dysheme, në nivel të dyshemesë ose mbi dysheme	2011	Fp
	EN 50085-2-3:2010 Cable trunking systems and cable ducting systems for electrical installations - Part 2-3: Particular requirements for slotted cable trunking systems intended for installation in cabinets	SSH EN 50085-2-3:2010 Sistemi i kanalinave për kabllo dhe sistemet me tuba për kabllo për instalime elektrike - Pjesa 2-3: Kërkesa të veçanta për sistemet e kanalinave me çarje gjatësor për kabllo të paracaktuara për instalime në kabinete	2010	Fp
	EN 50085-2-4:2009 Cable trunking systems and cable ducting systems for electrical installations - Part 2-4: Particular requirements for service poles and service posts	SSH EN 50085-2-4:2009 Sistemi i kanalinave për kabllo dhe sistemet me tuba për kabllo për instalime elektrike - Pjesa 2-4: Kërkesa të veçanta pikat e shërbimit dhe për vendet e shërbimit	2011	Fp
	EN 50106:2008 Safety of household and similar electrical appliances - Particular rules for routine tests referring to appliances under the scope of EN 60335-1	SSH EN 50106:2008 Siguria e pajisjeve elektrike shtëpiake dhe pajisjeve elektrike të ngjashme me to - Rregullat e veçanta për provat e zakonshme që i referohen pajisjeve nën fushën e standardit EN 60335-1	2008	Fp
	EN 50117-1:2002 Coaxial cables - Part 1: Generic specification	SSH EN 50117-1:2002 Kabllot koaksialë të përdorur në rrjetet e shpërndarjes kabllore - Pjesa 1: Specifikime të përgjithshme	2007	Fp
	EN 50117-1:2002/A1:2006	SSH EN 50117 -1:2002/A1:2006	2010	Fp
	EN 50117-1:2002/A2:2013	SSH EN 50117-1:2002/A2:2013	2014	Fp
	EN 50117-2-1:2005 Coaxial cables - Part 2-1: Sectional specification for cables used in cabled distribution networks - Indoor drop	SSH EN 50117-2-1:2005 Kabllot koaksialë - Pjesa 2-1: Specifikimet e seksionit për kabllot që përdoren në rrjetet kabllore të shpërndarjes - Kabllot e	2007	Fp

	cables for systems operating at 5 MHz - 1 000 MHz	mjediseve të brendshme për sistemet që punojnë në 5 MHz - 1000 MHz		
	EN 50117-2-1:2005/A1:2008	SSH EN 50117-2-1:2005/A1:2008	2010	Fp
	EN 50117-2-1:2005/A2:2013	SSH EN 50117-2-1:2005/A2:2013	2014	Fp
	EN 50117-2-2:2004 Coaxial cables - Part 2-2: Sectional specification for cables used in cabled distribution networks - Outdoor drop cables for systems operating at 5 MHz - 1 000 MHz	SSH EN 50117-2-2:2004 Kabllot koaksialë - Pjesa 2-2: Specifikimet e seksionit për kabllot që përdoren në rrjetet kabllore të shpërndarjes - Kabllot e mjediseve të jashtëme për sistemet që punojnë në 5 MHz - 1000 MHz	2007	Fp
	EN 50117-2-2:2004/A1:2008	SSH EN 50117-2-2:2004/A1:2008	2010	Fp
	EN 50117-2-2:2004/A2:2013	SSH EN 50117-2-2:2004/A2:2013	2014	Fp
	EN 50117-2-3:2004 Coaxial cables - Part 2-3: Sectional specification for cables used in cabled distribution networks - Distribution and trunk cables for systems operating at 5 MHz - 1 000 MHz	SSH EN 50117-2-3:2004 Kabllot koaksialë - Pjesa 2-3: Specifikimet e seksionit për kabllot që përdoren në rrjetet kabllore të shpërndarjes - Kabllot e shpërndarjes dhe të distancave të gjata për sistemet që punojnë në 5 MHz - 1000 MHz	2007	Fp
	EN 50117-2-3:2004/A1:2008	SSH EN 50117-2-3:2004/A1:2008	2010	Fp
	EN 50117-2-3:2004/A2:2013	SSH EN 50117-2-3:2004/A2:2013	2014	Fp
	EN 50117-2-4:2004 Coaxial cables - Part 2-4: Sectional specification for cables used in cabled distribution networks - Indoor drop cables for systems operating at 5 MHz - 3 000 MHz	SSH EN 50117-2-4:2004 Kabllot koaksialë - Pjesa 2-4: Specifikimet e seksionit për kabllot që përdoren në rrjetet kabllore të shpërndarjes - Kabllot e mjediseve të brendshme për sistemet që punojnë në 5 MHz - 3000 MHz	2007	Fp
	EN 50117-2-4:2004/A1:2008	SSH EN 50117-2-4:2004/A1:2008	2010	Fp
	EN 50117-2-4:2004/A2:2013	SSH EN 50117-2-4:2004/A2:2013	2014	Fp
	EN 50117-2-5:2004 Coaxial cables - Part 2-5: Sectional specification for cables used in cabled distribution networks - Outdoor drop cables for systems operating at 5 MHz - 3 000 MHz	SSH EN 50117-2-5:2004 Kabllot koaksialë - Pjesa 2-5: Specifikimet e seksionit për kabllot që përdoren në rrjetet kabllore të shpërndarjes - Kabllot e mjediseve të jashtme për sistemet që punojnë në 5 MHz - 3000 MHz	2007	Fp
	EN 50117-2-5:2004/A1:2008	SSH EN 50117-2-5:2004/A1:2008	2010	Fp
	EN 50117-2-5:2004/A2:2013	SSH EN 50117-2-5:2004/A2:2013	2014	Fp
	EN 50117-2-5:2004/AC:2012	SSH EN 50117-2-5:2004/AC:2012	2013	Fp
	EN 50117-3-1:2002 Coaxial cables - Part 3-1: Sectional specifications for cables used in Telecom applications - Miniaturized cables used in digital communication systems	SSH EN 50117-3-1:2002 Kabllot koaksialë - Pjesa 3-1:Specifikimet e seksionit për kabllot që përdoren në zbatimet e telekomit - Kabllot miniaturë që përdoren në sistemet e komunikimit dixhital	2007	Fp
	EN 50117-4-1:2008 Coaxial cables - Part 4-1: Sectional specification for cables for BCT cabling in accordance with EN 50173 - Indoor drop cables for systems operating at 5 MHz - 3 000 MHz	SSH EN 50117-4-1:2008 Kabllot koaksialë - Pjesa 4-1: Specifikim i seksionuar për kabllot në kabllimin BCT në përputhje me EN 50173 - Kabllot lidhës për përdorim të brendshëm në sisteme që veprojnë në frekuencat 5 MHz - 3 000 MHz	2008	Fp
	EN 50117-4-1:2008/A1:2013	SSH EN 50117-4-1:2008/A1:2013	2014	Fp

	EN 50117-4-2:2015 Coaxial cables - Part 4-2: Sectional specification for CATV cables up to 6 GHz used in cabled distribution networks	SSH EN 50117-4-2:2015 Kabllot koaksiale - Pjesa 4-2: Specifikim sektorial për kabllot CATV deri në 6 GHz të përdorura në rrjetat e shpërndarjes kabllore	2016	Fp
	EN 50156-1:2004 Electrical equipment for furnaces and ancillary equipment - Part 1: Requirements for application design and installation	SSH EN 50156-1:2004 Pajisjet elektrike për furnaltat dhe pajisjet ndihmëse - Pjesa 1: Kërkesat për instalimin dhe projektimin	2008	Fp
	EN 50156-1:2015 Electrical equipment for furnaces and ancillary equipment - Part 1: Requirements for application design and installation	SSH EN 50156-1:2015 Pajisje elektrike për furra dhe pajisje ndihmëse - Pjesa 1: Kërkesa për zbatim, projektim dhe instalim	2016	Fp
	EN 50156-2:2015 Electrical equipment for furnaces and ancillary equipment - Part 2: Requirements for design, development and type approval of safety devices and subsystems	SSH EN 50156-2:2015 Pajisjet elektrike për furra dhe pajisje ndihmëse - Pjesa 2: Kërkesat për projektim, zhvillim dhe lloji i aprovimit të sigurisë së pajisjes dhe nënsistemet	2016	Fp
	EN 50178:1997 Electronic equipment for use in power installations	SSH EN 50178:1997 Pajisja elektronike për përdorim në instalimet e fuqisë	2005	Fp
	EN 50214:2006 Flat polyvinyl chloride sheathed flexible cables	SSH EN 50214:2006 Kabllot fleksibël të veshur me polivinil kloridi të sheshtë	2008	Fp
	EN 50214:2006/AC:2007	SSH EN 50214:2006/AC:2007	2011	Fp
	EN 50250:2002 Conversion adaptors for industrial use	SSH EN 50250:2002 Adaptorët e kthimit për përdorim industrial	2006	Fp
	EN 50250:2002/AC:2007	SSH EN 50250:2002/AC:2007	2011	Fp
	EN 50250:2002/A1:2015	SSH EN 50250:2002/A1:2015	2015	Fp
	EN 50274:2002 Low-voltage switchgear and controlgear assemblies - Protection against electric shock - Protection against unintentional direct contact with hazardous live parts	SSH EN 50274:2002 Tërësia e pajisjeve të tensionit të ulët - Mbrojtja nga goditja elektrike - Mbrojtja nga kontakti i drejtpërdrejtë i paqëllimshëm me pjesët e rrezikshme nën tension	2005	Fp
	EN 50274:2002/AC:2009	SSH EN 50274:2002/AC:2009	2011	Fp
	EN 50288-7:2005 Multi-element metallic cables used in analogue and digital communication and control - Part 7: Sectional specification for instrumentation and control cables	SSH EN 50288-7:2005 Kabllot metalikë shumë elementësh që përdoren në kontrollin dhe komunikimin analog dhe dixhital - Pjesa 7: Specifikime i seksionit për përdorimin e instrumentave dhe kabllot e kontrollit	2008	Fp
	EN 50288-8:2012 Multi-element metallic cables used in	SSH EN 50288-8:2012 Kabllot metalike shumë-elementësh të	2013	Fp

	analogue and digital communication and control - Part 8: Specification for type 1 cables characterised up to 2 MHz	përdorura për komunikimin dhe kontrollin analog dhe dixhital - Pjesa 8: Specifikim për kabllo të tipit 1 i karakterizuar deri në 2 MHz		
	EN 50288-9-1:2012 Multi-element metallic cables used in analogue and digital communication and control - Part 9-1: Sectional specification for screened cables characterised up to 1 000 MHz - Horizontal and building backbone cables	SSH EN 50288-9-1:2012 Kabllot metalike shumë-elementësh të përdorura për komunikimin dhe kontrollin analog dhe dixhital - Pjesa 9-1: Specifikim seksional për kabllo të ekranizuar të karakterizuar deri në 1 000 MHz - Kabllot horizontale dhe të kolonave të ndërtesës	2013	Fp
	EN 50288-9-2:2015 Multi-element metallic cables used in analogue and digital communication and control - Part 9-2: Sectional specification for screened cables characterized from 1 MHz up to 1 000 MHz for work area, patch cord and data centre applications	SSH EN 50288-9-2:2015 Kabllot metalikë shumë-elementësh që përdoren në komunikimin analog dhe dixhital dhe kontrollin - Pjesa 9-2: Specifikim seksional për kabllo të ekranizuar të karakterizuar nga 1 MHz deri në 500 MHz për hapësirë pune me fije të bandazhuara dhe qendër të dhënash për zbatime	2016	Fp
	EN 50288-10-1:2012 Multi-element metallic cables used in analogue and digital communication and control - Part 10-1: Sectional specification for screened cables characterized up to 500 MHz - Horizontal floor and building backbone cables	SSH EN 50288-10-1:2012 Kabllot metalike shumë-elementësh të përdorura për komunikimin dhe kontrollin analog dhe dixhital - Pjesa 10-1: Specifikim seksional për kabllo të ekranizuar të karakterizuar deri në 500 MHz - Kabllot e dyshemeve horizontale dhe të kolonave të ndërtesës	2013	Fp
	EN 50288-11-1:2012 Multi-element metallic cables used in analogue and digital communication and control - Part 11-1: Sectional specification for un-screened cables characterised up to 500 MHz - Horizontal and building backbone cables	SSH EN 50288-11-1:2012 Kabllot metalike shumë-elementësh të përdorura për komunikimin dhe kontrollin analog dhe dixhital - Pjesa 11-1: Specifikim seksional për kabllo të pa ekranizuar të karakterizuar deri në 500 MHz - Kabllot horizontale dhe të kolonave të ndërtesës	2013	Fp
	EN 50289-1-3:2001 Communication cables - Specifications for test methods - Part 1-3: Electrical test methods - Dielectric strength	SSH EN 50289-1-3:2001 Kabllot e komunikimit - Specifikimet për metodat e proves - Pjesa 1-3: Metodat e provës elektrike - Qëndrueshmëria dielektrike	2007	Fp
	EN 50289-1-4:2001 Communication cables - Specifications for test methods - Part 1-4: Electrical test methods - Insulation resistance	SSH EN 50289-1-4:2001 Kabllot e komunikimit - Specifikimet për metodat e proves - Pjesa 1-4: Metodat e provës elektrike - Rezistenca e izolimit	2007	Fp
	EN 50290-2-1:2005 Communication cables - Part 2-1: Common design rules and construction	SSH EN 50290-2-1:2005 Kabllot e komunikimit - Pjesa 2-1: Rregullat e projektimit të zakonshëm dhe ndërtimi	2008	Fp
	EN 50290-2-20:2001 Communication cables - Part 2-20:	SSH EN 50290-2-20:2001 Kabllot e komunikimit - Pjesa 2-20:	2007	Fp

	Common design rules and construction - General	Rregullat e zakonshme të projektimit dhe ndërtimi - Të përgjithshme		
	EN 50290-2-21:2001 Communication cables - Part 2-21: Common design rules and construction - PVC insulation compounds	SSH EN 50290-2-21:2001 Kabllot e komunikimit - Pjesa 2-21: Rregullat e zakonshme të projektimit dhe ndërtimi - Përbërësit e izolimit PVC	2007	Fp
	EN 50290-2-21:2001/A1:2007	SSH EN 50290-2-21:2001/A1:2007		Fp
	EN 50290-2-21:2001/AC:2003	SSH EN 50290-2-21:2001/AC:2003	2011	Fp
	EN 50290-2-21:2001/A1:2007/AC:2016	SSH EN 50290-2-21:2001/A1:2007/AC:2016	2016	Fp
	EN 50290-2-22:2001 Communication cables - Part 2-22: Common design rules and construction - PVC sheathing compounds	SSH EN 50290-2-22:2001 Kabllot e komunikimit - Pjesa 2-22: Rregullat e zakonshme të projektimit dhe ndërtimi - Përbërësit e izolimit PVC	2007	Fp
	EN 50290-2-22:2001/A1:2007	SSH EN 50290-2-22:2001/A1:2007		Fp
	EN 50290-2-23:2013 Communication cables - Part 2-23: Common design rules and construction - Polyethylene insulation for multi-pair cables used in access telecommunication networks: Outdoor cables	SSH EN 50290-2-23:2013 Kabllot e komunikimit - Pjesa 2-23: Rregullat e zakonshme të projektimit dhe ndërtimit - Izolim prej polietileni për kabllot shumëçiftëshe të përdorur ne rrjetat e aksesit të telekomunikacionit: Kabllot për mjedise të jashtme	2014	Fp
	EN 50290-2-24:2002 Communication cables - Part 2-24: Common design rules and construction - PE sheathing	SSH EN 50290-2-24:2002 Kabllot e komunikacionit - Pjesa 2-24: Rregulla të zakonshme projektimi dhe ndërtimi - Veshja prej polietileni	2008	Fp
	EN 50290-2-24:2002/A1:2008	SSH EN 50290-2-24:2002/A1:2008	2011	Fp
	EN 50290-2-25:2013 Communication cables - Part 2-25: Common design rules and construction - Polypropylene insulation compounds	SSH EN 50290-2-25:2013 Kabllot e komunikimit - Pjesa 2-25: Rregullat e zakonshme të projektimit dhe ndërtimit - Përbërjet izoluese prej polipropileni	2014	Fp
	EN 50290-2-26:2002 Communication cables - Part 2-26: Common design rules and construction - Halogen free flame retardant insulation compounds	SSH EN 50290-2-26:2002 Kabllot e komunikacionit - Pjesa 2-26: Rregulla të zakonshme projektimi dhe ndërtimi - Komponimet izoluese ngadalësuese të flakës dhe pa halogjen	2008	Fp
	EN 50290-2-26:2002/A1:2007	SSH EN 50290-2-26:2002/A1:2007	2011	Fp
	EN 50290-2-27:2002 Communication cables - Part 2-27: Common design rules and construction - Halogen free flame retardant thermoplastic sheathing compounds	SSH EN 50290-2-27:2002 Kabllot e komunikacionit - Pjesa 2-27: Rregulla të zakonshme projektimi dhe ndërtimi - Komponimet veshëse termoplastike ngadalësuese të flakës dhe pa halogjen	2008	Fp
	EN 50290-2-27:2002/A1:2007	SSH EN 50290-2-27:2002/A1:2007	2011	Fp
	EN 50290-2-27:2002/A1:2007/AC:2010	SSH EN 50290-2-27:2002/A1:2007/AC:2010	2014	Fp
	EN 50290-2-28:2002 Communication cables - Part 2-28: Common design rules and construction - Filling compounds for filled cables	SSH EN 50290-2-28:2002 Kabllot e komunikacionit - Pjesa 2-28: Rregulla të zakonshme projektimi dhe ndërtimi - Komponimet mbushës për kabllot e mbushura	2008	Fp

	EN 50290-2-29:2002 Communication cables - Part 2-29: Common design rules and construction - Cross-linked PE insulation compounds	SSH EN 50290-2-29:2002 Kabllot e komunikacionit - Pjesa 2-29: Rregulla të zakonshme projektimi dhe ndërtimi - Komponimet izoluese me rrjetëzim prej polietileni	2008	Fp
	EN 50290-2-30:2002 Communication cables - Part 2-30: Common design rules and construction - Poly(tetrafluoroethylene-hexafluoropropylene) (FEP) insulation and sheathing	SSH EN 50290-2-30:2002 Kabllot e komunikacionit - Pjesa 2-30: Rregulla të zakonshme projektimi dhe ndërtimi - Veshje dhe izolim prej poli(tetrafluoretilen - hegzafluorpropilen)	2008	Fp
	EN 50290-4-1:2014 Communication cables - Part 4-1: General considerations for the use of cables - Environmental conditions and safety aspects	SSH EN 50290-4-1:2014 Kabllo për komunikim - Pjesa 4-1: Metodat e provës mjedisore - Konsiderata të përgjithshme për përdorimin e kabllove - Kushtet mjedisore dhe aspektet e sigurisë	2015	Fp
	EN 50290-4-2:2014 Communication cables - Part 4-2: General considerations for the use of cables - Guide to use	SSH EN 50290-4-2:2014 Kabllo për komunikim - Pjesa 4-2: Konsiderata të përgjithshme për përdorimin e kabllove - Udhëzues për përdorim	2015	Fp
	EN 50363-0:2011 Insulating, sheathing and covering materials for low-voltage energy cables - Part 0: General introduction	SSH EN 50363-0:2011 Materialet e izolimit, mbuluese dhe veshëse për kabllot e energjisë me tensionit të ulët - Pjesa 0: Paraqitje e përgjithshme	2012	Fp
	EN 50363-1:2005 Insulating, sheathing and covering materials for low voltage energy cables - Part 1: Cross-linked elastomeric insulating compounds	SSH EN 50363-1:2005 Materialet e izolimit, veshjes dhe mbulimit për kabllot elektrik të tensionit të ulët - Pjesa 1: Materialet elektroizolues elastike të rrjetëzuara	2008	Fp
	EN 50363-2-1:2005 Insulating, sheathing and covering materials for low voltage energy cables - Part 2-1: Cross-linked elastomeric sheathing compounds	SSH EN 50363-2-1:2005 Materialet e izolimit, veshjes dhe mbulimit për kabllot elektrik të tensionit të ulët - Pjesa 2-1: Materialet veshëse elastike të rrjetëzuara	2008	Fp
	EN 50363-2-1:2005/A1:2011	SSH EN 50363-2-1:2005/A1:2011	2012	Fp
	EN 50363-2-2:2005 Insulating, sheathing and covering materials for low voltage energy cables - Part 2-2: Cross-linked elastomeric covering compounds	SSH EN 50363-2-2:2005 Materialet e izolimit, veshjes dhe mbulimit për kabllot elektrik të tensionit të ulët - Pjesa 2-2: Materialet mbuluese elastike të rrjetëzuara	2008	Fp
	EN 50363-3:2005 Insulating, sheathing and covering materials for low voltage energy cables - Part 3: PVC insulating compounds	SSH EN 50363-3:2005 Materialet e izolimit, veshjes dhe mbulimit për kabllot elektrik të tensionit të ulët - Pjesa 3: Materialet elektroizoluese prej PVC-je	2008	Fp
	EN 50363-3:2005/A1:2011	SSH EN 50363-3:2005/A1:2011	2012	Fp

	EN 50363-4-1:2005 Insulating, sheathing and covering materials for low voltage energy cables - Part 4-1: PVC sheathing compounds	SSH EN 50363-4-1:2005 Materialet e izolimit, veshjes dhe mbulimit për kabllot elektrik të tensionit të ulët - Pjesa 4-1: Materialet veshëse prej PVC-je	2008	Fp
	EN 50363-4-2:2005 Insulating, sheathing and covering materials for low voltage energy cables - Part 4-2: PVC covering compounds	SSH EN 50363-4-2:2005 Materialet e izolimit, veshjes dhe mbulimit për kabllot elektrik të tensionit të ulët - Pjesa 4-2: Materialet mbuluese prej PVC-je	2008	Fp
	EN 50363-5:2005 Insulating, sheathing and covering materials for low voltage energy cables - Part 5: Halogen-free, cross-linked insulating compounds	SSH EN 50363-5:2005 Materialet e izolimit, veshjes dhe mbulimit për kabllot elektrik të tensionit të ulët - Pjesa 5: Materialet elektroizolues të rrjetëzuar pa halogjene	2008	Fp
	EN 50363-5:2005/A1:2011	SSH EN 50363-5:2005/A1:2011	2012	Fp
	EN 50363-6:2005 Insulating, sheathing and covering materials for low voltage energy cables - Part 6: Halogen-free, cross-linked sheathing compounds	SSH EN 50363-6:2005 Materialet e izolimit, veshjes dhe mbulimit për kabllot elektrik të tensionit të ulët - Pjesa 6: Materialet veshëse të rrjetëzuar pa halogjene	2008	Fp
	EN 50363-6:2005/A1:2011	SSH EN 50363-6:2005/A1:2011	2012	Fp
	EN 50363-7:2005 Insulating, sheathing and covering materials for low voltage energy cables - Part 7: Halogen-free, thermoplastic insulating compounds	SSH EN 50363-7:2005 Materialet e izolimit, veshjes dhe mbulimit për kabllot elektrik të tensionit të ulët - Pjesa 7: Materialet elektroizoluese termoplastike pa halogjen	2008	Fp
	EN 50363-8:2005 Insulating, sheathing and covering materials for low voltage energy cables - Part 8: Halogen-free, thermoplastic sheathing compounds	SSH EN 50363-8:2005 Materialet e izolimit, veshjes dhe mbulimit për kabllot elektrik të tensionit të ulët - Pjesa 8: Materialet veshëse termoplastike pa halogjen	2008	Fp
	EN 50363-8:2005/A1:2011	SSH EN 50363-8:2005/A1:2011	2012	Fp
	EN 50363-9-1:2005 Insulating, sheathing and covering materials for low voltage energy cables - Part 9-1: Miscellaneous insulating compounds - Cross-linked polyvinyl chloride (XLPVC)	SSH EN 50363-9-1:2005 Materialet e izolimit, veshjes dhe mbulimit për kabllot elektrik të tensionit të ulët - Pjesa 9-1: Materialet elektroizoluese të përziera - Polivinil kloridi i rrjetëzuar (XLPVC)	2008	Fp
492.	EN 62026-3:2015 Low-voltage switchgear and controlgear - Controller-device interfaces (CDIs) - Part 3: DeviceNet	SSH EN 62026-3:2015 Pajisje shpërndarëse dhe kontrolli për tension të ulët - Ndërfaqe për pajisjen kontrolluese (CDIs) - Pjesa 3: DeviceNet	2015	Fp
493.	EN 62031:2008 LED modules for general lighting - Safety specifications	SSH EN 62031:2008 Modulet LED për ndriçim në përgjithësi - Specifikime të sigurisë	2010	Fp
	EN 62031:2008/A1:2013	SSH EN 62031:2008/A2:2015	2015	Fp
	EN 62031:2008/A2:2015	SSH EN 62031:2008/A1:2013	2014	Fp
494.	EN 62035:2014 Discharge lamps (excluding fluorescent lamps) - Safety specifications	SSH EN 62035:2014 Llamba gazshkarkuese (përjashtuar llambat fluorishente) - Specifikime të sigurisë	2015	Fp
495.	EN 62040-1:2008 Uninterruptible power systems (UPS) - Part 1: General and safety requirements for UPS	SSH EN 62040-1:2008 Sistemet e fuqisë së pandërprerë (UPS) - Pjesa 1: Kërkesat e përgjithshme dhe të sigurisë për sistemet e fuqisë së pandërprerë (UPS)	2009	Fp
	EN 62040-1:2008/AC:2009	SSH EN 62040-1:2008/A1:2013	2014	Fp
	EN 62040-1:2008/A1:2013	SSH EN 62040-1:2008/AC:2009	2011	Fp
496.	EN 62080:2009 Sound signalling devices for household and similar purposes	SSH EN 62080:2009 Aparate sinjalizimi zanor për pajisjet elektroshtëpiake dhe pajisje të ngjashme me to	2010	Fp
497.	EN 62094-1:2003 Indicator light units for household and similar fixed-electrical installations - Part 1: General requirements	SSH EN 62094-1:2003 Tregues me dritë për instalimet elektrike të palëvizshme shtëpiake dhe të ngjashme me to - Pjesa 1: Kërkesa të përgjithshme	2005	Fp
	EN 62094-1:2003/A11:2003	SSH EN 62094-1:2003/A11:2003	2008	Fp
498.	EN 62109-1:2010 Safety of power converters for use in photovoltaic power systems - Part 1: General requirements	SSH EN 62109-1:2010 Siguria e konvertuesve të fuqisë për përdorim në sistemet e energjisë fotovoltaike - Pjesa 1: Kërkesa të përgjithshme	2011	Fp
499.	EN 62109-2:2011 Safety of power converters for use in photovoltaic power systems - Part 2: Particular requirements for inverters	SSH EN 62109-2:2011 Siguria e shndëruesve të fuqisë për përdorim në sistemet fotovoltaike - Pjesa 2: Kërkesa të veçanta për inverterat	2012	Fp
500.	EN 62135-1:2015 Resistance welding equipment - Part 1: Safety requirements for design, manufacture and installation	SSH EN 62135-1:2015 Pajisje për saldimin me rezistencë - Pjesa 1: Kërkesat e sigurisë për projektimin, prodhimin dhe instalimin	2016	Fp

501.	EN 62196-1:2014 Plugs, socket-outlets, vehicle connectors and vehicle inlets - Conductive charging of electric vehicles - Part 1: General requirements	SSH EN 62196-1:2014 Spinat, prizat, konektoret dhe hyrjet e automjeteve - Karikimi konduktiv i automjeteve elektrike - Pjesa 1: Kërkesa të përgjithshme	2015	Fp
502.	EN 62196-2:2012 Plugs, socket-outlets, vehicle connectors and vehicle inlets - Conductive charging of electric vehicles - Part 2: Dimensional compatibility and interchangeability requirements for a.c. pin and contact-tube accessories	SSH EN 62196-2:2012 Spinat, prizat, kabllot dhe prizat për karikimin e automjeteve - Karikimi konduktiv i automjeteve elektrike - Pjesa 2: Kërkesat përmasore te pajtueshmërisë dhe ndërkëmbyeshmërisë për spinotin dhe aksesorët e tubit të kontaktit	2012	Fp
	EN 62196-2:2012/A12:2014	SSH EN 62196-2:2012/A12:2014	2015	Fp
	EN 62196-2:2012/A11:2013	SSH EN 62196-2:2012/A12:2014/AC:2014	2014	Fp
	EN 62196-2:2012/A12:2014/AC:2014	SSH EN 62196-2:2012/A11:2013		Fp
503.	EN 62196-3:2014 Plugs, socket-outlets, vehicle connectors and vehicle inlets - Conductive charging of electric vehicles - Part 3: Dimensional compatibility and interchangeability requirements for d.c. and a.c./d.c. pin and contact-tube vehicle couplers	SSH EN 62196-3:2014 Spinat, prizat, konektorët dhe hyrjet për automjetet - Karikimi konduktiv i automjeteve elektrike - Pjesa 3: Kërkesat përmasore të pajtueshmërisë dhe ndërkëmbyeshmërisë për kunjin me rrymë të vazhduar dhe rrymë alternative/rrymë e vazhduar dhe bashkuesit e tubit të kontaktit të automjetit	2015	Fp
504.	EN 62208:2011 Empty enclosures for low-voltage switchgear and controlgear assemblies - General requirements	SSH EN 62208:2011 Kuti për pjesët bashkuese të pajisjeve të komutimit dhe kontrollit për tension të ulët - Kërkesa të përgjithshme	2012	Fp
505.	EN 62233:2008 Measurement methods for electromagnetic fields of household appliances and similar apparatus with regard to human exposure	SSH EN 62233:2008 Metodat e matjes së fushës elektromagnetike të pajisjeve elektrike shtëpiake dhe të ngjashme me to që lidhen me ekspozimin e njeriut ndaj këtyre fushave	2008	Fp
	EN 62233:2008/AC:2008	SSH EN 62233:2008/AC:2008	2011	Fp
506.	EN 62253:2011 Photovoltaic pumping systems - Design qualification and performance measurements	SSH EN 62253:2011 Sistemet fotovoltaike të pompimit - Projektimi, përcaktimi i cilësisë dhe matjet e performancës	2012	Fp
507.	EN 62275:2015 Cable management systems - Cable ties for electrical installations	SSH EN 62275:2015 Sistemi i menaxhimit të kabllove - Fasheta për kabllo për instalime elektrike	2015	Fp
508.	EN 62282-3-100:2012 Fuel cell technologies - Part 3-100: Stationary fuel cell power systems - Safety	SSH EN 62282-3-100:2012 Teknologjitë e pilave të djegshme - Pjesa 3-100: Sistemet e pilave të djegshme stacionare - Siguria	2012	Fp

509.	EN 62282-3-300:2012 Fuel cell technologies - Part 3-300: Stationary fuel cell power systems - Installation	SSH EN 62282-3-300:2012 Teknologjia e pilave me lëndë djegëse - Pjesa 3-300: Sistemet stacionare te fuqisë së pilave (celulave) me lëndë djegëse - Instalimi	2013	Fp
510.	EN 62282-5-1:2012 Fuel cell technologies - Part 5-1: Portable fuel cell power systems - Safety	SSH EN 62282-5-1:2012 Teknologjitë e pilave të djegshme - Pjesa 5-1: Sistemet e pilave të djegshme portative - Siguria	2013	Fp
511.	EN 62310-1:2005 Static transfer systems (STS) - Part 1: General and safety requirements	SSH EN 62310-1:2005 Sistemet e transferimit static (STS) - Pjesa 1: Kërkesa të përgjithshme dhe të sigurisë	2008	Fp
512.	EN 62311:2008 Assessment of electronic and electrical equipment related to human exposure restrictions for electromagnetic fields (0 Hz - 300 GHz	SSH EN 62311:2008 Vlerësimi i pajisjeve elektrike dhe elektronike në lidhje me kufizimet e ekspozimit të njeriut ndaj fushave elektromagnetike (0Hz – 300 GHz)	2008	Fp
513.	EN 62368-1:2014 Audio/video, information and communication technology equipment - Part 1: Safety requirements	SSH EN 62368-1:2014 Pajisje audio/video, të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit - Pjesa 1: Kërkesat e sigurisë	2015	Fp
	EN 62368-1:2014/AC:2015	SSH EN 62368-1:2014/AC:2015	2016	Fp
514.	EN 62395-1:2013 Electrical resistance trace heating systems for industrial and commercial applications - Part 1: General and testing requirements	SSH EN 62395-1:2013 Sistemet ngrohëse me rezistancë elektrike për zbatime industriale dhe tregtare - Pjesa 1: Kërkesat e përgjithshme dhe të provës	2014	Fp
515.	EN 62423:2012 Type F and type B residual current operated circuit-breakers with and without integral overcurrent protection for household and similar uses	SSH EN 62423:2012 Ndërprerësit e qarkut të tipit B dhe F që operojnë me rrymë mbetëse, me ose pa mbrojtje të integruar nga mbi rryma, për përdorime shtëpiake dhe të ngjashme me të	2013	Fp
516.	EN 62444:2013 Cable glands for electrical installations	SSH EN 62444:2013 Nyje bashkuese kabllosh për instalime elektrike	2014	Fp
517.	EN 62471:2008 Photobiological safety of lamps and lamp systems	SSH EN 62471:2008 Siguria fotobiologjike e llambave dhe sistemeve të llambave	2009	Fp
518.	EN 62477-1:2012 Safety requirements for power electronic converter systems and equipment - Part 1: General	SSH EN 62477-1:2012 Kërkesat e sigurisë për sistemet dhe pajisjet elektronike të shndërrimit të fuqisë - Pjesa 1: Të përgjithshme	2013	Fp
	EN 62477-1:2012/A11:2014	SSH EN 62477-1:2012/A11:2014	2015	Fp
519.	EN 62479:2010 Assessment of the compliance of low power electronic and electrical equipment with the basic restrictions	SSH EN 62479:2010 Vlerësimi i përputhshmërisë së pajisjeve elektrike dhe elektronike të fuqisë së ulët me kufizimet bazë lidhur me ekspozimin	2011	Fp

	related to human exposure to electromagnetic fields (10 MHz to 300 GHz	njerëzor ndaj fushave elektromagnetike (10 MHz deri në 300 GHz)		
520.	EN 62532:2011 Fluorescent induction lamps - Safety specifications	SSH EN 62532:2011 Llambat fluoreshente me induksion - Specifikimet e sigurisë	2012	Fp
521.	EN 62549:2011 Articulated systems and flexible systems for cable guiding	SSH EN 62549:2011 Sisteme të artikuluara dhe sisteme të përkulshme për udhëzimin e kabllove	2012	Fp
522.	EN 62560:2012 Self-ballasted LED-lamps for general lighting services by voltage > 50 V - Safety specifications	SSH EN 62560:2012 Llambat LED me vet rregullim të rrymës për shërbime të përgjithshme ndriçimi me tension > 50 V - Specifikime sigurie	2013	Fp
	EN 62560:2012/A1:2015	SSH EN 62560:2012/A1:2015	2016	Fp
	EN 62560:2012/A1:2015/AC:2015	SSH EN 62560:2012/A1:2015/AC:2015		Fp
	EN 62560:2012/AC:2015	SSH EN 62560:2012/AC:2015		Fp
523.	EN 62606:2013 General requirements for arc fault detection devices	SSH EN 62606:2013 Kërkesa të përgjithshme për pajisjet për zbulimin e defektit të harkut	2014	Fp
524.	EN 62626-1:2014 Low-voltage switchgear and controlgear enclosed equipment - Part 1: Enclosed switch-disconnectors outside the scope of IEC 60947-3 to provide isolation during repair and maintenance work	SSH EN 62626-1:2014 Mbylljet e pajisjeve të komutimi dhe kontrolli për tension të ulët - Pjesa 1: Ndarësit e çelësave të mbyllur që nuk përfshihen në qëllimin e IEC 60947-3 për të siguruar izolim gjatë mirëmbajtjes dhe riparimit	2014	Fp
525.	HD 62640:2015 Residual current devices with or without overcurrent protection for socket-outlets for household and similar uses	SSH HD 62640:2015 Pajisje të rrymës mbetëse me ose pa mbrojtje nga mbirryma për prizat dhe çelësat për përdorime shtëpiake dhe të ngjashme me to	2015	Fp
526.	EN 62776:2015 Double-capped LED lamps designed to retrofit linear fluorescent lamps - Safety specifications	SSH EN 62776:2015 Llamba LED me dy xokola projektuar për të zëvendësuar llambat fluoreshente lineare - Specifikime të sigurisë	2015	Fp
527.	EN 62868:2015 Organic light emitting diode (OLED) panels for general lighting - Safety requirements	SSH EN 62868:2015 Panele diodash emetimi të dritës organike (OLED) për ndriçim të përgjithshëm - Kërkesa sigurie	2016	Fp
528.	EN 62949:2017 Particular safety requirements for equipment to be connected to information and communication networks	SSH EN 62949:2017 Kërkesa të sigurisë specifike për pajisjet që lidhen me rrjetet e informacionit dhe komunikimit	2018	Fp
529.	EN IEC 63044-3:2018 Home and Building Electronic Systems (HBES) and Building Automation and Control Systems (BACS) - Part 3: Electrical safety requirements	SSH EN IEC 63044-3:2018 Sistemet elektronike të shtëpisë dhe ndërtesës (HBES) dhe Sistemet e kontrollit dhe automatizimit të ndërtesës (BACS) - Pjesa 3: Kërkesat e sigurisë elektrike	2018	Fp

UDHËZIM
Nr. 81, datë 6.3.2020

PËR KLASIFIKIMIN E OBJEKTEVE, SIPAS RREZIKSHMËRISË NGA ZJARRI, PROCEDURAT E SHQYRTIMIT DHE TË MIRATIMIT TË PROJEKTIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN, SI DHE DHËNIA E CERTIFIKATËS SË SIGURISË NGA ZJARRI

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3, të nenit 41, të ligjit nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin",

UDHËZOJ:

I. KLASIFIKIMI I OBJEKTEVE SIPAS RREZIKSHMËRISË NGA ZJARRI

1. Objektet/aktivitetet, sipas rrezikshmërisë nga zjarri, pranisë së substancave të djegshme, madhësisë apo kompleksitetit që paraqesin, klasifikohen në 3 (tri) kategori:

a) A, "Objekte/aktivitete me risk të ulët";

b) B, "Objekte/aktivitete me risk të mesëm";

c) C, "Objekte/aktivitete me risk të lartë".

2. Objektet/aktivitetet të klasifikuara, sipas pikës 1, të këtij kreu, u nënshtrohen kontrolleve për parandalimin e zjarrit, sipas parimit të proporcionalitetit në identifikimin e shkallës së rrezikut ndaj zjarrit.

3. Në kategorinë A, "Objekte/aktivitete me risk të ulët", përfshihen objektet/aktivitetet, që paraqesin:

a) një nivel të kufizuar të rrezikut ndaj zjarrit;

b) shkallë të ulët të ndezshmërisë së substancave të djegshme të pranishme;

c) rrezikshmëri të ulët dhe të limituar të përhapjes së zjarrit.

3.1 Për kategorinë A nuk është i domosdoshëm hartimi i një projekti të plotë të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas kategorisë që i përket, por mjafton hartimi i "Relacionit teknik" për mbrojtjen pasive dhe aktive të tërësisë së masave për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin.

4. Në kategorinë B, "Objekte/aktivitete me risk të mesëm", përfshihen objektet/aktivitetet, që paraqesin:

a) shkallë të mesme të ndezshmërisë së substancave të djegshme të pranishme;

b) rrezikshmëri të kufizuar të përhapjes së zjarrit.

4.1 Për kategorinë B është e nevojshme të hartohet një projekt i plotë i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas kategorisë që i përket. Shërbimi vendor i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, në vijim "MZSH", verifikon përputhshmërinë e projektit të mbrojtjes nga zjarri me normat teknike të sigurisë nga zjarri dhe shpëtimin dhe, pasi e miraton, kryen inspektime për zbatimit të tij.

5. Në kategorinë C, "Objekte me risk të lartë", ku përfshihen edhe objektet/aktivitetet me rëndësi ekonomiko-strategjike kombëtare, paraqesin:

a) shkallë të lartë të ndezshmërisë të substancave, të cilat favorizojnë përhapjen e zjarrit;

b) rrezikshmëri të theksuar të rënies, përhapjes së zjarrit, si dhe për shpërthim.

5.1 Për kategorinë C është e nevojshme të hartohet një projekt i plotë i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas kategorisë që i përket. Para miratimit të projektit, shërbimi vendor i MZSH-së duhet të kryejë inspektime dhe verifikime në objekt/aktivitet dhe mund të kërkojë ndryshime të projektit të paraqitur, me qëllim respektimin e normave teknike të sigurisë nga zjarri dhe shpëtimin.

II. SHQYRTIMI I PROJEKTIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN DHE PROCEDURA E MIRATIMIT

1. Projekti i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objektet të kategorizuara në kreun I të këtij udhëzimi, është pjesë përbërëse e dokumentacionit tekniko-ligjor që kërkohet për lëshimin e lejes së zhvillimit/ndërtimit të objekteve të reja, të atyre ekzistuese, si dhe për çdo ndryshim të destinacionit të objektit/aktivitetit.

2. Projekti i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin paraqitet për shqyrtim dhe për miratim nëpërmjet sistemit elektronik *e-Leje*, së bashku me aplikimin për leje zhvillimi/ndërtimi.

3. Shërbimi i MZSH-së, nëpërmjet sistemit elektronik *e-Leje*, shqyrton dhe mund të japë mendim, të pranojë, të miratojë apo të refuzojë kërkesën për miratimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

4. Për objektet me rëndësi ekonomiko-strategjike kombëtare, me rrezikshmëri të theksuar

të rënies, përhapjes së zjarrit dhe për shpërthim, si dhe për zhvillimet komplekse, sipas rregullores së zhvillimit të territorit, projekti i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin shqyrtohet nga shërbimi qendror i MZSH-së, në bashkëpunim me Sekretariatin Teknik të Këshilli Kombëtar të Territorit.

5. Shërbimi i MZSH-së, brenda 7 (shtatë) ditëve nga paraqitja e aplikimit për leje zhvillimi/ndërtimi, shqyrton:

a) nëse subjekti legjitimohet për të paraqitur kërkesë;

b) plotësimin e saktë të të gjitha të dhënave të detyrueshme, sipas formularëve nr. 1 dhe nr. 1/1, "Vlerësimi i projektit të MZSH-së", bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse të tij;

c) paraqitjen e të gjitha dokumenteve (paraqitje grafike, relacioni teknik), të detyrueshme për miratimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;

d) përputhshmërinë e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin me lejen e zhvillimit/ndërtimit, me planin e detajuar vendor, si dhe me normat teknike të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin;

e) dokumentacionin e projektuesit (ekspertit zjarrfikës), i cili duhet të përmbajë edhe deklaratën e përgjegjësisë mbi përputhshmërinë e projektit, me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga zjarri;

f) nëse është kryer pagesa e tarifës për vlerësimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

6. Nëse projekti i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin nuk është në përputhje me kushtet për dhënien e lejes së zhvillimit/ndërtimit, me planin e detajuar vendor, me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin për mbrojtjen nga zjarri apo, në rast se personi nuk legjitimohet për të paraqitur kërkesën, shërbimi i MZSH-së, në nivel vendor apo qendror, brenda afatit të përcaktuar në pikën 5, të këtij kreu, merr vendim të arsyetuar për refuzimin e kërkesës dhe njofton me shkrim aplikuesin.

7. Në rast se dokumentacioni i cili duhet të shoqërojë projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin rezulton i plotë, por nuk është kryer pagesa e tarifës për vlerësimin e këtij projekti, shërbimi i MZSH-së në nivel vendor apo qendror njofton aplikuesin që të kryejë pagesën brenda 5 ditëve nga njoftimi.

8. Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, shërbimi i MZSH-së, në nivel vendor apo qendror, njofton aplikuesin, që brenda 5 ditëve nga njoftimi të kryejë plotësimin e dokumentacionit.

9. Me dërgimin e njoftimeve, sipas pikave 7 dhe 8 të këtij kreu, afati për shqyrtimin e kërkesës pezullohet deri në plotësimin e dokumentacionit dhe/ose pagesës së tarifës nga aplikuesi. Nëse subjekti nuk plotëson dokumentacionin ose nuk paguan tarifën për vlerësimin e projektit, brenda afatit të caktuar, shërbimi i MZSH-së, në nivel vendor apo qendror, merr vendim të arsyetuar për refuzimin e kërkesës.

10. Refuzimi apo kthimi për plotësim të dokumentacionit tekniko-ligjor për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin nga punonjësi i autorizuar i shërbimit të MZSH-së bëhet i arsyetuar, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

11. Nëse shërbimi i MZSH-së, brenda afatit të përcaktuar në pikën 5 të këtij kreu, nuk njofton aplikuesin për mangësi në dokumentacion apo për detyrimin e pagesës së tarifës, projekti i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin konsiderohet i miratuar në heshtje dhe aplikimi për leje zhvillimi/ndërtimi dërgohet pranë autoritetit përgjegjës, sipas legjislacionit për planifikimin dhe për zhvillimin e territorit për marrjen e vendimit përfundimtar.

12. Në rast se dokumentacioni është i plotë dhe është kryer pagesa e tarifës të shërbimit, aplikimi konsiderohet i pranuar për shqyrtim të mëtejshëm dhe aplikimi për leje zhvillimi/ndërtimi dërgohet pranë autoritetit përgjegjës, sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për marrjen e vendimit përfundimtar.

III. PROCEDURA E LËSHIMIT TË CERTIFIKATËS SË SIGURISË NGA ZJARRI

1. Certifikata e Sigurisë nga Zjarri, në vijim "CSZ", sipas formularit nr. 2 dhe 2.1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, është akti administrativ i lëshuar nga shërbimi i MZSH-së, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, nëpërmjet të cilit provohet përmbushja e kërkesave të parashikuara në projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas kategorizimit të objekteve.

2. Aplikuesi për CSZ-në paraqet kërkesë nëpërmjet sistemit elektronik *e-Albania*, vetëm pasi ka përfunduar procesi i zhvillimit/i ndërtimit.

3. Kërkesa e aplikuesit për t'u pajisur me CSZ pranohet për vlerësim të mëtejshëm nga shërbimi i MZSH-së, në nivel vendor vetëm, në rastet kur:

a) aplikuesi legjitimohet për të paraqitur kërkesë;

b) provohet dhe dokumentohet shkresërisht procedura e miratimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objektin/aktivitetin;

c) vërtetohet gjendja faktike e marrjes së masave pasive/aktive të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në përputhje me kushtet e lejes së zhvillimit/ndërtimit, si dhe dokumenteve të planifikimit;

d) është kryer pagesa e tarifës për marrjen e CSZ-së.

4. Në rast se aplikuesi nuk përmbush kriterin e përcaktuar në germën "b", të pikës 3 të këtij kreu, informohet për të rifilluar procedurën e miratimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

5. Inspektori i autorizuar i shërbimit të MZSH-së në nivel vendor, gjatë këqyrjes së gjendjes faktike në objekt/aktivitet të masave pasive/aktive të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, ka për detyrë të:

a) plotësojë me përgjegjësi rubrikat e formularit nr. 3, "Vlerësimi i riskut nga zjarri", bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi;

b) të hartojë relacionin shpjegues lidhur me gjetjet gjatë inspektimit në objekt/aktivitet, për masat e mbrojtjes nga zjarri, të cilin e paraqet pranë drejtuesit të shërbimit të MZSH-së.

6. Shërbimi i MZSH-së, në rast se konstaton mospërputhje të punimeve me kërkesat e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, lëshon aktin e konstatimit, duke dhënë sugjerimet përkatëse dhe afatin kohor për plotësimin e mangësive. Në këtë rast, afati për lëshimin e CSZ-së pezullohet.

7. Nëse brenda afatit kohor të përcaktuar në aktin e konstatimit, sipas pikës 6 të këtij kreu, nuk përmbushen sugjerimet e shërbimit të MZSH-së, inspektorët vendorë të MZSH-së vendosin sanksione për administratorët e objektit/aktivitetit apo subjektet përgjegjëse, sipas parashikimit të ligjit për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin dhe aplikimi për lëshimin e CSZ-së refuzohet.

8. Shërbimi i MZSH-së lëshon CSZ, në rastet kur:

a) Relacioni shpjegues sipas germës "b", të pikës 5 të këtij kreu, vërteton përmbushjen e detyrave të caktuara në projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;

b) janë përmbushur kriteret e sigurisë, që kërkon legjislacioni për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, të pasqyruara nga inspektori i autorizuar në formularin nr. 3, "Vlerësimi i riskut nga zjarri", në objekt/aktivitet.

9. Për objektet e kategorisë C, sipas pikës 1, të kreut I të këtij udhëzimi, inspektori i autorizuar i shërbimit vendor të MZSH-së, pas kërkesës së aplikuesit dhe pas verifikimit të kompetencës administrative, ka për detyrë të:

a) verifikojë në vend objektin, lidhur me marrjen e masave pasive/aktive të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në përputhje me kushtet e lejes së zhvillimit/ndërtimit, si dhe dokumenteve të planifikimit;

b) dërgojë pranë shërbimit qendror të MZSH-së, relacionin shpjegues të firmosur elektronikisht nga drejtuesi i shërbimit, lidhur me masat pasive/aktive për mbrojtjen nga zjarri.

9.1 Shërbimi qendror i MZSH-së, për objektet e kategorisë C, vlerëson plotësimin e kushteve dhe të standardeve të sigurisë nga zjarri dhe, brenda 30 ditëve nga paraqitja e aplikimit, duhet të marrë vendim për lëshimin apo refuzimin e kërkesës së aplikuesit.

10. Në rast se gjatë monitorimit periodik të zhvillimeve në territor, përmes sistemit elektronik *e-Leje* apo gjatë kontrollit të veprimtarisë së strukturave të shërbimit të MZSH-së, konstatohet se për objektet me rëndësi ekonomike-strategjike kombëtare, që paraqesin rrezikshmëri të theksuar të rënies, përhapjes së zjarrit dhe shpërthim apo për zhvillimet komplekse, sipas rregullores së zhvillimit të territorit, projekti i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin dhe CSZ-ja janë miratuar nga shërbimi vendor i MZSH-së, ndaj personave përgjegjës fillohet procedura e ecurisë disiplinore, sipas parashikimeve të legjislacionit për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

11. Afati i vlefshmërisë të CSZ është:

a) pa afat për objektet/aktivitetet të kategorisë A, sipas përcaktimit në germën "a", të pikës 1, të kreut I të këtij udhëzimi;

b) me afat 5-vjeçar, me të drejtë ripërtëritje për objektet/aktivitetet të kategorisë B, sipas përcaktimit në germën "b", të pikës 1, të kreut I të këtij udhëzimi;

c) me afat 3-vjeçar, me të drejtë ripërtëritje për objektet/aktivitetet të kategorisë C, sipas

përcaktimit në germën "c", të pikës 1, të kreut I të këtij udhëzimi.

12. Afatet e përcaktuara në germat "b" dhe "c", të pikës 12 të këtij kreu, janë të vlefshme në rastet kur objektet/aktivitetet nuk ndryshojnë elemente thelbësore të strukturës së tyre apo nuk ndryshojnë destinacionin e përdorimit. Në rast të kundërt, pronarët apo administratorët e këtyre objekteve/aktiviteteve janë të detyruar të aplikojnë për miratim shtesë të projektit ekzistues të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe për ripërtëritje të CSZ-së, në përputhje me treguesit dhe mënyrat e ndërhyrjes në projekt, instalimet e reja, modifikim, zgjerim apo rikonstruksion i aktivitetit ekzistues.

13. Shërbimi i MZSH-së, në nivel vendor apo qendror, mund të revokojë CSZ të lëshuar, në rastet kur:

a) pas procedurës së inspektimit, kryesisht apo të autorizuar, objekti/aktiviteti nuk përmbush kushtet dhe standardet në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas kategorizimit të objekteve;

b) nga inspektorët vendorë të shërbimit të MZSH-së konstatohen shkelje të rënda ose ndryshime thelbësore në kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë objekti/aktiviteti, sipas projektit të miratuar dhe certifikatës së lëshuar;

c) konstatohen të dhëna të rreme në dokumentet e aplikimit të subjektit.

14. Vendimi i marrë nga drejtuesi i shërbimit të MZSH-së për revokimin e CSZ-së duhet të jetë i arsyetuar dhe ndaj tij lejohet ankim në Gjykatën Administrative kompetente, brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin përkatës në fuqi.

IV. PROCEDURAT E RIPËRTËRITJES SË CERTIFIKATËS TË SIGURISË NGA ZJARRI

1. Për ripërtëritjen e CSZ-së, sipas formularëve nr. 4 dhe 4/1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, për objektet/aktivitetet e kategorisë B dhe C, sipas pikës 1, të kreut I të këtij udhëzimi, subjekti paraqet kërkesë në bashkinë përkatëse, ku ndodhet objekti apo ushtrohet aktiviteti, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara mbarimit të afatit të vlefshmërisë së saj.

2. Me paraqitjen e kërkesës për ripërtëritjen e CSZ-së, shërbimi i MZSH-së në nivel vendor:

a) për objektet/aktivitetet e kategorisë B planifikon inspektim të autorizuar për të verifikuar respektimin e normave dhe standardeve në fushën e sigurisë nga zjarri;

b) për objektet/aktivitetet e kategorisë C, pas verifikimit në vend të objektit/aktivitetit, lidhur me përputhshmërinë e masave aktive/pasive të mbrojtjes nga zjarri, dërgon shkresërisht relacion shpjegues, si dhe çdo akt teknik për mbrojtjen nga zjarri të lëshuar për objektin/aktivitetin përkatës, lidhur me gjetjet dhe gjendjen faktike të masave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, pranë shërbimit qendror të MZSH-së, i cili rast pas rasti lëshon/refuzon certifikatën përkatëse.

3. Procedura për lëshimin e CSZ-së e parashikuar në kreun III të këtij udhëzimi, do të zbatohet edhe në rastin e ripërtëritjes periodike të saj.

4. Gjatë procedurës së ripërtëritjes së CSZ-së, së cilës i ka kaluar afati i vlefshmërisë, ajo do të konsiderohet e vlefshme deri në përfundim të afateve të parashikuara në këtë udhëzim, për shqyrtimin e kërkesës për ripërtëritjen e saj.

V. ADMINISTRIMI I DOKUMENTACIONIT TEKNIK QË SHËRBEN PËR VLERËSIMIN E PROJEKTIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN DHE CERTIFIKATËS SË SIGURISË NGA ZJARRI

1. Dokumentacioni tekniko-ligjor (relacioni teknik) që shoqëron projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, përgatitur nga një ekspert i licencuar, sipas pikës 4, të nenit 49, të ligjit nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", në rastin e objekteve/aktiviteteve të kategorisë A, B, C, që nuk janë sipas normave teknike dhe standardeve në fushën e MZSH-së, përmban:

a) Identifikimin e rreziqeve nga zjarri, bazuar në:

- substancat e rrezikshme dhe mënyrat e tyre të ruajtjes;
- ngarkesa e zjarrit në ndarje të ndryshme të objektit;
- sistemet teknologjike të shërbimit;
- zonat me rrezik të veçantë;
- llojin e sistemeve elektrike normale apo të sistemeve tokësore me referenca specifike ndaj rregullave për mbrojtjen nga zjarri.

b) Përshkrimin e kushteve mjedisore duke vlerësuar riskun, në lidhje me:

- aksesueshmërinë dhe qëndrueshmërinë;
- përshkrimi i distancave, ndarjet, izolimi;

- karakteristikat e ndërtesave (llojet e ndërtesës, gjeometria, volumi, sipërfaqet, lartësitë, dyshemetë nëntokësore, nënndarjet etj.);
- ventilimin;
- vende të konsideruara të sigurta;
- rrugët e evakuimit.

c) Përpunimet grafike (disenjim grafik), planimetria e përgjithshme në shkallë (nga 1:2000 deri në 1:200), ku përfshihen:
- vendndodhja e veprimtarisë në lidhje me zonën përreth;
- distanca të jashtme të sigurisë;
- burimet ujore në zonë (hidrantët e jashtëm, puset, ujësjellësit publikë etj.);
- sistemet e jashtme teknologjike (nënstacionet elektrike, linjat elektrike, rrjetet e gazit, sistemet e shpërndarjes së gazit teknik etj.);
- vendndodhjen e pajisjeve manovruese të impianteve të mbrojtjes nga zjarri dhe të blloqeve emergjente të sistemeve teknologjike;
- planet, seksionet dhe lartësitë në shkallë (1:50, 1:100 ose 1:200) të ndërtesave, instalimeve, depove, distancat e sigurisë, vendndodhjen e pajisjeve të zjarrfikësve, përdorimin e objekteve, ndriçimin e sigurisë.

2. Punonjësi i shërbimit të MZSH-së në nivel vendor, i autorizuar për inspektimin, sipas pikës 5, të kreut III të këtij udhëzimi, pas vlerësimit dhe miratimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në çdo rast mban kopje të këtij projekti dhe të çdo dokumenti tjetër që lidhet me procedurat e vlerësimit, miratimit, refuzimit, si dhe të plotësimit të dokumentacionit nga sistemi elektronik i lejeve.

3. Dokumentacioni që shërbimi i MZSH-së duhet të shqyrtojë, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, administrohet dhe ruhet në dosje përkatëse për çdo objekt, në përputhje me afatet e parashikuara nga legjislacioni për arkivat. Çdo akt i dosjes duhet të ketë numër unik, i cili identifikon objektin/aktivitetin të pasuar në mënyrë progresive nga numra me fraksion, sipas rendit rritës.

4. Në rastet kur veprohet sipas parashikimeve të pikës 4, të kreut të II, dokumentacioni administrohet nga shërbimi i MZSH-së në nivel vendor dhe qendror.

5. Shërbimi i MZSH-së, në nivel vendor dhe qendror, mban dhe administron regjistra me fletë të numërtuara dhe të sekretuara me vulë nga protokolli dhe të emërtuar:

a) regjistri i miratimit të projekteve të mbrojtjes nga zjarri, sipas formularit nr. 5, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

b) regjistri i certifikatave së sigurisë nga zjarri, sipas formularit nr. 5/1, bashkëlidhur këtij dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

c) regjistri i ripërtëritjes së certifikatave të sigurisë nga zjarri, sipas formularit nr. 5/2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

6. Regjistrat e emërtuar, sipas pikës 5 të këtij kreu, shërbejnë si inventar për administrimin e shkresave gjatë veprimtarisë së shërbimit të MZSH-së, që krijohet, ruhet, mirëmbahet, administrohet dhe përditësohet, në mënyrë të pavarur nga struktura inspektuese të këtij shërbimi.

7. Regjistrat e emërtuar, sipas pikës 5 të këtij kreu prodhohen pranë Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë, sipas legjislacionit për prokurimin publik.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për sigurimin e zbatimit dhe kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj

VULA

Formulari nr.1

STEMA E BASHKISË
BASHKIA_____
DREJTORIA/SEKTORI I MZSH

FORMULARI I VLERËSIMIT TË PROJEKTIT TË MZSH

I nënshkruari _____ (Emri) _____ (Mbiemri)

Banues në _____ (adresa) _____ (Numri i identifikimit të letërnjoftimit) . _____ (Bashkia)

_____ (telefoni) _____ (Numri i NIPTTT të personit fizik)

_____ (telefax) _____ (Adresa e postës elektronike)

Në cilësinë e personit: _____ (Statusi zyrtar (pronari, përfaqësuesi ligjor, avokat, administratori, pronari, menaxher, etj)

dhe _____ (Emri i objektit/aktivitetit, ndërmarrje, institucion, korporatë, shoqatë, etj

Bazuar në _____ (adresa)

_____ (Bashkia) _____ (zona) _____ (telefoni)

_____ (telefax) _____ (Adresa e postës elektronike)

Në përputhje me nenin 39, pikën 1, 2, 4 të nenit 41 të ligjit nr.152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", **vlerësoj** dhe

MIRATOJ

PROJEKTIN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

Për objektin e _____ (Lloji i punës (zgjidhjes së re, modifikim, zgjerim, rinovim, etj)

Aktivitetin lidhur _____ (Lloji i objektit, lloji i biznesit, aktivitetit (objekt banimi, hotel, shkollë,, etj)

Të vendosura në _____ (bashkia) _____ (zona) _____ (telefoni)

t _____ .

Dokumentacioni teknik është nënshkruar nga eksperti zjarrfikës

_____ (Numri i lejes) _____ (Emri) _____ (Mbiemri)

Eksperti zjarrfikës regjistruar si person fizik/juridik _____ Nr. regjistrimit _____

_____ (adresa) _____ (Numri i regjistrimit NIPT)

_____ (bashkia)

_____ (tetefon) _____ (Adresa e postës elektronike)

Hapësira për shënime për shërbimin e MZSH-së

FORMULARI I VLERËSIMIT TË PROJEKTIT TË MZSH

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

a) INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME LIDHUR OBJEKTIN DHE AKTIVITETIN QË USHTROHET LIDHUR ME MASAT E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN.

b) TREGUESIT DHE MËNYRAT E NDËRHYRJES NË PROJEKT: INSTALIMI I RI OSE MODIFIKIM, ZGJERIMIN APO RISTRUKTURIMIN I AKTIVITETIT EKZISTUES.

Bashkëlidhur këtij formulari paraqiten nga projektuesi apo investitori aplikues, apo personi i autorizuar dokumentet e mëposhtme të projektit, të nënshkruar nga një ekspert zjarrfikës i licencuar në përputhje me pikën 4 të nenit 49 të ligjit nr.152/2015.
- Relacioni teknik;
- Dokumentacioni (dizajni) grafik.

Formulari Informativ i vlerësimit të projektit të MZSH-së plotësohet në dy kopje. Njëra kopjet i jepet aplikuesit pas miratimit të projektit dhe kopja tjetër administrohet nga shërbimi i MZSH-së, së bashku me dokumentacionin e përcaktuar.

(Nga punonjësi i autoriauar për të miratuar projektin e MZSH-së hartohet procesverbal për inventarin e dokumenteve që paraqet aplikuesi dhe ky procesverbal administrohet së bashku me dokumentacionin e sipërcituar).

INSPEKTORI I AUTORIZUAR;
(Emër/mbiemër/firmë)

DREJTORI/SHEFI I SEKTORIT TË MZSH
(Emër/mbiemër/firmë/vulë)

Nr. Praktikës MZSH
_____

Formulari nr.1/1 **vula**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E MZSH

FORMULARI I VLERËSIMIT TË PROJEKTIT TË MZSH

I nënshkruari _____ (Emri) _____ (Mbiemri)

Banues në _____ (adresa) _____ (Numri i identifikimit të letërnjoftimit) _____ (Bashkia)

_____ (telefoni) _____ (Numri i NIPTIT të personit fizik)

_____ (telefax) _____ (Adresa e postës elektronike)

Në cilësinë e personit: _____

(Statusi zyrtar (pronari, përfaqësuesi ligjor, avokat, administratori, pronari, menaxher, etj)

dhe _____

(Emri i objektit/aktivitetit, ndërmarrje, institucion, korporatë, shoqatë, etj

Bazuar në _____ (adresa)

_____ (Bashkia) _____ (zona) _____ (telefoni)

_____ (telefax) _____ (Adresa e postës elektronike)

Në përputhje me nenin 39, pikën 1, 2, 4 të nenit 41 të ligjit nr.152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", **vlerësoj** dhe

MIRATOJ

PROJEKTIN E MBOJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

Për objektin e _____

(Lloji i punës (zgjidhjes së re, modifikim, zgjerim, rinovim, etj)

Aktivitetin lidhur _____

(Lloji i objektit, lloji i biznesit, aktivitetit (objekt banimi, hotel, shkollë,, etj)

Të vendosura në _____

_____ (bashkia) _____ (zona) _____ (telefoni)

_____

t _____ .

Dokumentacioni teknik është nënshkruar nga eksperti zjarrfikës

_____ (Numri i lejes) _____ (Emri) _____ (Mbiemri)

Eksperti zjarrfikës regjistruar si person fizik/juridik _____ Nr. regjistrimit _____

_____ (adresa) _____ (Numri i regjistrimit NIPT)

_____ (bashkia)

_____ (tetefon) _____ (Adresa e postës elektronike)

FORMULARI I VLERËSIMIT TË PROJEKTIT TË MZSH

Hapësira për shënime për shërbimin e MZSH-së

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

a) INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME LIDHUR OBJEKTIN DHE AKTIVITETIN QË USHTROHET LIDHUR ME MASAT E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN.

b) TREGUESIT DHE MËNYRAT E NDËRHYRJES NË PROJEKT: INSTALIMI I RI OSE MODIFIKIM, ZGJERIMIN APO RISTRUKTURIMIN I AKTIVITETIT EKZISTUES.

FORMULARI I VLERËSIMIT TË PROJEKTIT TË MZSH

Bashkëlidhur këtij formulari paraqiten nga projektuesi apo investitori aplikues, apo personi i autorizuar dokumentet e mëposhtme të projektit, të nënshkruar nga një ekspert zjarrfikës i licencuar në përputhje me pikën 4 të nenit 49 të ligjit nr.152/2015.

- Relacioni teknik; apo Raporti Teknik për Fillimin e Aktivitetit
- Dokumentacioni (dizajni) grafik.

Formulari i vlerësimit të projektit të MZSH-së plotësohet në dy kopje. Njëra kopjet i jepet aplikuesit pas miratimit të projektit dhe kopja tjetër administrohet nga shërbimi i MZSH-së, së bashku me dokumentacionin e përcaktuar.

(Punonjësi i autorizuar për të miratuar projektin e MZSH-së harton procesverbal për inventarin e dokumenteve që paraqet aplikuesi dhe ky procesverbal administrohet së bashku me dokumentacionin e sipërcituar).

DREJTORI I MZSH
(Emër/mbiemër/firmë/vulë)

Nr. Praktikës MZSH
_____

STEMA E BASHKISË
BASHKIA_____
DREJTORIA/SEKTORI I MZSH

Formulari nr. 2

CERTIFIKATË PËR SIGURINË NGA ZJARRI

Mbështetur në pikën 2 të nenit 3, pikat 3, 4 të nenit 41 të ligjit nr.152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", si dhe duke konsideruar kontrollin teknik të realizuar në objekt në datë ___.___.20_____, nga punonjësi i autorizuar i MZSH (emër mbiemër i Inspektorit);

LËSHOJMË:

Certifikatën e Sigurisë nga Zjarri (CSZ), në datë ___.___.20____, për respektimin e rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, për parandalimin e zjarreve, si dhe për ekzistencën e kushteve të sigurisë kundër zjarreve në objektin e kategorizuar (kategoria ___), sipas Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm.

Emri/adresa e objektit:

_____

Aktiviteti i ushtruar në objekt:

_____

Procesi i vlerësimit të projektit (miratimi nga shërbimi i MZSH);

☐ miratim fillestar i projektit të MZSH (data/muaji/viti)

_____

Lëndët/substancat që paraqesin rrezik për zjarr apo shpërthim në objekt/aktivitet:

_____
_____

Sipërfaqja e përgjithshme e objektit/aktivitetit/lartësia/numri i kateve/mbi/nën nivelin zero:

_____

Impiantet aktive të mbrojtjes nga zjarri në objekt/aktivitet:

_____
_____
_____
_____
_____

Mjetet për fikjen e zjarreve:
Instalime të fiksuara për Mbrojtjen nga Zjarri:
Impiant për fikjen automatike të zjarreve (tip sprinkler):

_____
_____

Impiant hidrik antizjarr në objekt/aktivitet (diametri i hidrantit të instaluar);

_____

Impianti i fikseve të lëvizshme (numri në total i fikseve të zjarrit);

_____

Impianti i diktim/sinjalizimit të zjarrit/tymit (detektorët të instaluar) në objekt/aktivitet;

_____

Rezerva hidrike në objekt/aktivitet: _____

INSPEKTORI I AUTORIZUAR;
(Emër/mbiemër/firmë)

DREJTORI/SHEFI I SEKTORIT TË MZSH
(Emër/mbiemër/firmë/vulë)

Certifikata e Sigurisë nga Zjarri hartohet në tre kopje, një kopje i jepet aplikuesit, një kopje qëndron në protokoll/arkiv dhe kopja tjetër administrohet në dosjen e objektit/aktivitetit.

CERTIFIKATË PËR SIGURINË NGA ZJARRI

Nr. Praktikës MZSH _____

STEMA E BASHKISË **Formulari nr.3**
BASHKIA_____
DREJTORIA/SEKTORI I MZSH

CERTIFIKATË PËR SIGURINË NGA ZJARRI
(RIPËRTËRITJE PËR LEJIM AKTIVITETI)

Mbështetur në pikën 2 të nenit 3, pikat 3, 4 të nenit 41 të ligjit nr.152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", si dhe duke konsideruar kontrollin teknik të realizuar në datë ___.___.20_____, nga punonjësi i autorizuar i MZSH (emër mbiemër i Inspektorit);

LËSHOJMË:

Certifikatën e Sigurisë nga Zjarri për lejimin e ushtrimit të aktivitetit (CSZ), në datë ___.___.2019, për respektimin e rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, për parandalimin e zjarreve, si dhe për ekzistencën e kushteve të sigurisë kundër zjarreve në objektin e kategorizuar (kategoria ___), sipas Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm.

Emri/adresa e objektit:

_____

Aktiviteti i ushtruar në objekt:

_____

Procesi i vlerësimit të projektit (miratimi nga shërbimi i MZSH);

☐ miratim fillestar i projektit të MZSH ☐ modifikim i projektit të MZSH, sipas aktivitetit që ushtrohet/lejohet (data/muaji/viti)

_____

Lëndët/substancat që paraqesin rrezik për zjarr apo shpërthim në objekt/aktivitet:

_____

_____

Sipërfaqja e përgjithshme e objektit/aktivitetit/lartësia/numri i kateve/mbi/nën nivelin zero:

_____

Impiantet aktive të mbrojtjes nga zjarri në objekt/aktivitet:

_____

_____

_____

_____

_____

Mjetet për fikjen e zjarreve:
Instalime të fiksuara për Mbrojtjen nga Zjarri:
Impiant për fikjen automatike të zjarreve (tip sprinkler):

_____

_____

Impiant hidrik antizjarr në objekt/aktivitet (diametri i hidrantit të instaluar);

_____

Impianti i fikseve të lëvizshme (numri në total i fikseve të zjarrit);

_____

Impianti i diktim/sinjalizimit të zjarrit/tymit (detektorët të instaluar) në objekt/aktivitet;

_____

Rezerva hidrike në objekt/aktivitet: _____

INSPEKTORI I AUTORIZUAR;
(Emër/mbiemër/firmë)

DREJTORI/SHEFI I SEKTORIT TË MZSH
(Emër/mbiemër/firmë/vulë)

Certifikata e Sigurisë nga Zjarri (Ripërtëritje për lejim aktiviteti) hartohet në tre kopje, një kopje i jepet aplikuesit, një kopje qëndron në protokoll/arkiv dhe kopja tjetër administrohet në dosjen e objektit/aktivitetit.

RIPËRTËRITJE CERTIFIKATE PËR SIGURINË NGA ZJARRI
(PËR LEJIM AKTIVITETI)

Nr. Praktikës MZSH
_____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E MZSH

Formulari nr.2/1

CERTIFIKATË PËR SIGURINË NGA ZJARRI

Mbështetur në pikën 2 të nenit 3, pikat 3, 4 të nenit 41 të ligjit nr.152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", si dhe duke konsideruar kontrollin teknik të realizuar në objekt në datë ___.___.20_____, nga punonjësi i autorizuar i MZSH (emër mbiemër i Inspektorit);

LËSHOJMË:

Certifikatën e Sigurisë nga Zjarri (CSZ), në datë ___.___.___, për respektimin e rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, për parandalimin e zjarreve, si dhe për ekzistencën e kushteve të sigurisë kundër zjarreve në objektin e kategorizuar (kategoria ___), sipas Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm.

Emri/adresa e objektit:

_____

Aktiviteti i ushtruar në objekt:

_____

Procesi i vlerësimit të projektit (miratimi nga shërbimi i MZSH);

☐ miratim fillestar i projektit të MZSH (data/muaji/viti)

_____

Lëndët/substancat që paraqesin rrezik për zjarr apo shpërthim në objekt/aktivitet:

_____

_____

Sipërfaqja e përgjithshme e objektit/aktivitetit/lartësia/numri i kateve/mbi/nën nivelin zero:

_____

Impiantet aktive të mbrojtjes nga zjarri në objekt/aktivitet:

_____

_____

_____

_____

Mjetet për fikjen e zjarreve:
Instalime të fiksuara për Mbrojtjen nga Zjarri:
Impiant për fikjen automatike të zjarreve (tip sprinkler):

_____

_____

Impiant hidrik antizjarr në objekt/aktivitet (diametri i hidrantit të instaluar);

_____

Impianti i fikseve të lëvizshme (numri në total i fikseve të zjarrit);

_____

Impianti i diktim/sinjalizimit të zjarrit/tymit (detektorët të instaluar) në objekt/aktivitet;

_____

Rezerva hidrike në objekt/aktivitet: _____

DREJTORI I MZSH
(Emër/mbiemër/firmë/vulë)

Certifikata e Sigurisë nga Zjarri hartohet në tre kopje, një kopje i jepet aplikuesit, një kopje qëndron në protokoll/arkiv dhe kopja tjetër administrohet në dosjen e objektit/aktivitetit.

CERTIFIKATË PËR SIGURINË NGA ZJARRI

Nr. Praktikës MZSH
_____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E MZSH

Formulari 3/1

CERTIFIKATË PËR SIGURINË NGA ZJARRI
(RIPËRTËRITJE PËR LEJIM AKTIVITETI)

Mbështetur në pikën 2 të nenit 3, pikat 3, 4 të nenit 41 të ligjit nr.152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", si dhe duke konsideruar kontrollin teknik të realizuar në datë ___.___.20_____, nga punonjësi i autorizuar i MZSH (emër mbiemër i Inspektorit);

LËSHOJMË:

Certifikatën e Sigurisë nga Zjarri për lejimin e ushtrimit të aktivitetit (CSZ),në datë ___.___.20__, për respektimin e rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, për parandalimin e zjarreve, si dhe për ekzistencën e kushteve të sigurisë kundër zjarreve në objektin e kategorizuar (kategoria ___), sipas Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm.

Emri/adresa e objektit:
_____

Aktiviteti i ushtruar në objekt:
_____

Procesi i vlerësimit të projektit (miratimi nga shërbimi i MZSH);

☐ miratim fillestar i projektit të MZSH ushtrohet/lejohet (data/muaji/viti)

☐ modifikim i projektit të MZSH, sipas aktivitetit që

_____

Lëndët/substancat që paraqesin rrezik për zjarr apo shpërthim në objekt/aktivitet:
_____
_____

Sipërfaqja e përgjithshme e objektit/aktivitetit/lartësia/numri i kateve/mbi/nën nivelin zero:
_____

Impiantet aktive të mbrojtjes nga zjarri në objekt/aktivitet:
_____
_____
_____
_____

Mjetet për fikjen e zjarreve:
Instalime të fiksuara për Mbrojtjen nga Zjarri:
Impiant për fikjen automatike të zjarreve (tip sprinkler):
_____
_____
Impiant hidrik antizjarr në objekt/aktivitet (diametri i hidrantit të instaluar);
_____
Impianti i fikseve të lëvizshme (numri në total i fikseve të zjarrit);
_____
Impianti i diktim/sinjalizimit të zjarrit/tymit (detektorët të instaluar) në objekt/aktivitet;
_____
Rezerva hidrike në objekt/aktivitet: _____

DREJTORI I MZSH
(Emër/mbiemër/firmë/vulë)

Certifikata e Sigurisë nga Zjarri (Ripërtëritje për lejim aktiviteti) hartohet në tre kopje, një kopje i jepet aplikuesit, një kopje qëndron në protokoll/arkiv dhe kopja tjetër administrohet në dosjen e objektit/aktivitetit.

RIPËRTËRITJE CERTIFIKATE PËR SIGURINË NGA ZJARRI (PËR LEJIM AKTIVITETI)

Nr.
Praktikës
MZSH
_____

STEMA E BASHKISË
BASHKIA _____
DREJTORIA/SEKTORI I MZSH

Formulari nr.4

VLERËSIM I RISKUT NGA ZJARRI PËR OBJEKTIN/AKTIVITETIN

1. **Vendndodhja:** _____

2. **Administratori:** _____

II. KARTELA E MBROJTJES NGA ZJARRI PËR OBJEKTIN.

1. **Kufizimet dhe largësitë (m) me objektet kufizuese :**
- Veriu: _____ // ____ m.
- Lindja: _____ // ____ m.
- Jugu: _____ // ____ m.
- Perëndimi: _____ // ____ m.

2. **Numri i kateve dhe destinacioni i tyre:**
